



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.69

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9554 datë 8.6.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare”	1947
Ligj nr.9555 datë 8.6.2006	Për ratifikimin e konventës europiane “Për statusin ligjor të punëtorëve migrantë”	1956
Ligj nr.9556 datë 8.6.2006	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit “Rehabilitimi i Portit të Vlorës””	1968
Ligj nr.9557 datë 8.6.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen kuadër për bashkëpunimin ndërmjet shteteve frankofone të europës qendrore dhe lindore për zhvillimin e formimit profesional dhe teknik”	1979
Ligj nr.9558 datë 8.6.2006	Për një ndryshim në ligjin nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”	1982
Ligj nr.9559 datë 8.6.2006	Për një shtesë në ligjin nr.7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”	1982
Ligj nr.9561 datë 12.6.2006	Për disa ndryshime në ligjin nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”	1983
Dekret nr.4953 datë 4.7.2006	Për falje dënimi	1984

L I G J
Nr. 9554, datë 8.6.2006

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN “PËR NJOFTIMIN
DHE DORËZIMIN JASHTË SHTETIT TË DOKUMENTEVE GJYQËSORE DHE
JASHTËGJYQËSORE NË FUSHËN CIVILE DHE TREGTARE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare” të Konferencës së Hagës, bërë më 15 nëntor 1965, me deklaratimet e parashikuara në këtë ligj.

Neni 2

Në zbatim të nenit 21 të kësaj Konvente, Republika e Shqipërisë deklaron si më poshtë:

- a) në përputhje me nenin 2, autoritet qendror caktohet drejtoria që mbulon bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë;
- b) në përputhje me nenet 6 e 18, autoritet janë gjykatat, të cilat kanë kërkuar dokumentet gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në zbatim të kësaj Konvente;
- c) në përputhje me nenin 9, autoritet përgjegjës, për të marrë dokumentet e transmetuara me rrugë konsullore, caktohet drejtoria që mbulon çështjet konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4938, datë 27.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA
**PËR NJOFTIMIN DHE DORËZIMIN JASHTË SHTETIT TË DOKUMENTEVE GJYQËSORE
DHE JASHTËGJYQËSORE NË FUSHËN CIVILE DHE TREGTARE**

(Përfunduar më 15 nëntor 1965 dhe hyrë në fuqi më 15 shkurt 1969)

Shtetet palë në këtë Konventë,
duke dëshiruar të krijojnë mjetet e nevojshme për t’u siguruar që dokumentet gjyqësore dhe jashtëgjyqësore që dërgohen jashtë shtetit, do të trajtohen prej marrësit në një kohë të pranueshme,
duke dëshiruar përmirësimin e organizimit të ndihmës së ndërsjellë gjyqësore për atë qëllim, duke thjeshtuar dhe përsheptuar procedurat përkatëse,
vendosën të përfundojnë këtë Konventë dhe të merren vesh përsa u përket dispozitave të mëposhtme.

Neni 1

Kjo Konventë do të zbatohet në të gjitha rastet për çështje civile ose tregtare, ku ka rast për të transmetuar një dokument gjyqësor ose jashtëgjyqësor për t'u dërguar jashtë shtetit.

Kjo Konventë nuk do të zbatohet kur nuk dihet adresa e personit të cilit do t'i dërgohet dokumenti.

KAPITULLI I DOKUMENTET GJYQËSORE

Neni 2

Çdo Shtet Kontraktues do të caktojë një Autoritet Qendror, i cili do të marrë kërkesa për dërgim që vijnë nga Shtete të tjera Kontraktuese dhe të procedojë në përputhje me dispozitat e neneve 3 deri në 6.

Çdo Shtet do të organizojë Autoritetin Qendror në përputhje me ligjin e vet.

Neni 3

Autoriteti ose oficeri gjyqësor kompetent sipas ligjit të Shtetit në të cilin dokumentet e kanë origjinën do t'i parashtojë Autoritetit Qendror të Shtetit të adresuar një kërkesë në përputhje me modelin bashkëlidhur kësaj Konvente, pa ndonjë kërkesë legalizimi apo formalitet tjetër ekuivalent.

Dokumenti që do dërgohet ose një kopje e tij do t'i bashkëlidhet kërkesës. Kërkesa dhe dokumenti do të bëhen në dy kopje.

Neni 4

Nëse Autoriteti Qendror çmon se kërkesa nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, do të informojë menjëherë aplikantin dhe do të specifikojë kundërshtimet e tij ndaj kërkesës.

Neni 5

Autoriteti Qendror i Shtetit dërgues do të dërgojë dokumentin ose do ta rregullojë që ta dërgojë atë me anë të një metode të përshtatshme ose:

a) me një metodë të parashikuar nga ligji i saj i brendshëm për dërgimin e dokumenteve në paditë e brendshme për persona të cilët janë brenda territorit të saj ose

b) me anë të një metode të veçantë të kërkuar nga aplikanti, vetëm nëse kjo metodë nuk është në mospërputhje me ligjin e Shtetit Dërgues.

Objekt i nënparagrafit (b) të paragrafit të parë të këtij neni, dokumenti mund t'i dërgohet gjithmonë një marrësi që e pranon atë vullnetarisht.

Nëse dokumenti duhet të dërgohet sipas paragrafit të parë sa më sipër, Autoriteti Qendror mund të kërkojë që dokumenti të shkruhet ose të përkthehet në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të Shtetit Dërgues.

Ajo pjesë e kërkesës, në formën bashkëlidhur kësaj Konvente, e cila përmban një përmbledhje të dokumentit që duhet dërguar, do të dërgohet me këtë dokument.

Neni 6

Autoriteti Qendror i Shtetit Dërgues ose çdo autoritet që mund të ketë caktuar për atë qëllim, do të plotësojë një certifikatë në formën e modelit bashkëlidhur kësaj Konvente.

Në certifikatë do të deklarohet se dokumenti është dërguar dhe do të përfshijë metoden, vendin dhe datën e dërgimit dhe personin të cilit i është dërguar. Nëse dokumenti nuk është dërguar, në certifikatë do të paraqiten arsyet që kanë parandaluar dërgimin.

Aplikanti mund të kërkojë që një certifikatë e paplotësuar nga një Autoritet Qendror ose nga një autoritet gjyqësor do të kundërfirmoset nga një prej këtyre autoriteteve.

Certifikata do t'i paraqitet aplikantit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Neni 7

Termet standarde në modelin bashkëlidhur kësaj Konvente, në të gjitha rastet, do të jenë me shkrim në gjuhën frënge ose në atë angleze. Ato gjithashtu mund të jenë me shkrim në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të Shtetit nga i cili e kanë origjinën dokumentet.

Vendet korresponduese bosh do të plotësohen ose në gjuhën e shtetit që i drejtohen ose në gjuhën frënge apo angleze.

Neni 8

Çdo Shtet Kontraktues do të jetë i lirë për të kryer dërgimin e dokumenteve gjyqësore në lidhje me personat jashtë shtetit, pa zbatimin e ndonjë detyrimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet rrugëve të saj diplomatike ose konsullore.

Çdo shtet mund të deklarojë që është kundër këtij dërgimi brenda territorit të tij, përveç rasteve kur dokumenti i dërgohet një shtetasi të shtetit në të cilin dokumentet e kanë origjinën.

Neni 9

Për më tepër, çdo Shtet Kontraktues do të jetë i lirë për të përdorur rrugë konsullore për të paraqitur dokumente me qëllim dërgimin atyre autoriteteve të Shtetit tjetër Kontraktues, të cilët janë caktuar nga ky i fundit për këtë qëllim.

Në rrethana të jashtëzakonshme, çdo Shtet Kontraktues mund të kërkojë përdorimin e rrugëve konsullore për të njëjtin qëllim.

Neni 10

Nëse Shteti i destinacionit nuk ka kundërshtim, kjo Konventë nuk do të ndërhyjë në:

a) lirinë për të dërguar dokumente gjyqësore me postë në mënyrë të drejtpërdrejtë personave jashtë shtetit;

b) lirinë e oficerëve gjyqësorë, zyrtarëve ose personave të tjerë kompetentë të Shtetit të origjinës për të kryer dërgimin e dokumenteve gjyqësore në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet oficerëve gjyqësorë, zyrtarëve ose personave të tjerë kompetentë të Shtetit të destinacionit;

c) lirinë e çdo personi të interesuar në një procedim gjyqësor për të kryer dërgimin e dokumenteve gjyqësore në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet oficerëve gjyqësorë, zyrtarëve ose personave të tjerë kompetentë të Shtetit të destinacionit.

Neni 11

Kjo Konventë nuk do të ndalojë dy ose më shumë Shtete Kontraktuese nga rënia dakord për të lejuar, për qëllim të dërgimit të dokumenteve gjyqësore, rrugë transmetimi të ndryshme nga ato të parashikuara në nenet e mësipërme dhe, në veçanti, komunikimin e drejtpërdrejtë midis autoriteteve të tyre përkatëse.

Neni 12

Dërgimi i dokumenteve gjyqësore që vijnë nga një Shtet Kontraktues nuk do të mundësojnë ndonjë pagesë ose rimbursim të taksave ose kostove për dërgimet e dhëna nga Shteti Dërgues.

Aplikanti do të paguajë ose rimburojë kostot e shkaktuara nga:

- a) punësimi i oficerit gjyqësor ose i një personi kompetent sipas ligjit të Shtetit të destinacionit;
- b) përdorimi i një metode specifike dërgimi.

Neni 13

Kur një kërkesë për dërgim është në përputhje me kushtet e kësaj Konvente, Shteti Dërgues mund të refuzojë të jetë dakord me këtë vetëm nëse çmon që përputhshmëria do të shkelte sovranitetin ose sigurinë e tij.

Ai mund të mos refuzojë të jetë në përputhje vetëm mbi bazën se, sipas ligjit të tij të brendshëm, pretendon juridiksion të posaçëm mbi lëndën e padisë ose se ligji i saj i brendshëm nuk do të lejonte padinë mbi të cilën është bazuar aplikimi.

Në rast refuzimi, Autoriteti Qendror do të informojë menjëherë aplikantin dhe do të deklarojë arsyet e refuzimit.

Neni 14

Vështirësitë që mund të lindin në lidhje me transmetimin e dokumenteve gjyqësore për dërgim do të zgjidhen me rrugë diplomatike.

Neni 15

Kur një thirrje gjyqësore ose një dokument ekuivalent duhet të transmetohej jashtë shtetit për qëllim dërgimi, sipas dispozitave të kësaj Konvente dhe kur i padituri nuk është paraqitur, vendimi nuk do të jepet derisa të vërtetohet se:

- a) dokumenti është dërguar me anë të një metode të parashikuar nga ligji i brendshëm i shtetit dërgues për dërgimin e dokumenteve për paditë e brendshme mbi personat që janë brenda territorit të saj, ose

- b) dokumenti në të vërtetë i është dërguar të paditurit ose në banesën e tij me anë të një metode të ndryshme nga ajo e parashikuar nga kjo Konventë,

dhe se në secilin prej këtyre rasteve, dërgimi është kryer në kohën e nevojshme për t'i mundësuar të paditurit të mbrohet.

Secili Shtet Kontraktues do të jetë i lirë të deklarojë se gjykatësi, pavarësisht nga dispozitat e paragrafit të parë të këtij neni, mund të japë vendime edhe nëse nuk është marrë asnjë certifikatë dërgimi, nëse janë përmbushur të gjitha kusht mëposhtme:

- a) dokumenti është transmetuar me anë të njëres prej metodave të parashikuara në këtë Konventë;

- b) ka kaluar një periudhë kohore prej jo më pak se gjashtë muajsh që prej datës së transmetimit të dokumentit, e konsideruar e mjaftueshme nga gjykatësi në rastin specifik;

- c) nuk është marrë asnjë certifikatë e çfardolloji, edhe nëse është bërë çdo përpjekje e arsyeshme për ta përfutur atë nëpërmjet autoriteteve kompetente të Shtetit Dërgues.

Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve të mësipërm, gjykatësi mund të urdhërojë në rast urgjence, masa të përkohshme ose mbrojtëse.

Neni 16

Kur një thirrje gjyqësore ose një dokument ekuivalent duhet të transmetohej jashtë shtetit për qëllim dërgimi, sipas dispozitave të kësaj Konvente dhe është marrë një vendim kundër një të padituri i cili nuk është paraqitur, gjykatësi do të ketë kompetencën ta lehtësojë të paditurin nga efektet e skadimit të kohës për apel nga vendimi nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) i padituri, pa pasur faj nga ana e tij, nuk ka pasur dijeni për dokumentin në kohë të mjaftueshme për t'u mbrojtur ose nuk ka pasur dijeni për vendimin në kohë të mjaftueshme për të apeluar, dhe

b) i padituri ka zbuluar fillimisht mbrojtje ndaj padisë në themel.

Një aplikim për ndihmë mund të paraqitet vetëm brenda një kohe të arsyeshme, pasi i padituri të ketë marrë dijeni për vendimin.

Secili Shtet Kontraktues mund të deklarojë se aplikimi nuk do të merret në konsideratë nëse është paraqitur pas skadimit të një kohe që duhet deklaruar në deklaratë, por që në asnjë rast nuk do të jetë më pak se një vit pas datës së vendimit.

Ky nen nuk do të zbatohet për vendime në lidhje me statusin ose kapacitetin e personave.

KAPITULLI II DOKUMENTET JASHTËGJYQËSORE

Neni 17

Dokumentet jashtëgjyqësore që dalin nga autoritetet dhe oficerët gjyqësorë të një Shteti Kontraktues mund të transmetohen për qëllime dërgimi në një Shtet tjetër Kontraktues me anë të metodave dhe sipas dispozitave të kësaj Konvente.

KAPITULLI III DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 18

Secili Shtet Kontraktues mund të caktojë autoritete të tjera përveç Autoritetit Qendror dhe do të përcaktojë shkallën e kompetencës së tyre.

Megjithatë, aplikanti, në të gjitha rastet do të ketë të drejtën e adresimit të një kërkesë në mënyrë të drejtpërdrejtë Autoritetit Qendror.

Shtetet Federale do të jenë të lira të caktojnë më shumë se një Autoritet Qendror.

Neni 19

Në shkallën që ligji i brendshëm i një Shteti Kontraktues lejon metodat e transmetimit, të ndryshme nga ato të parashikuara në nenet e mëparshme të dokumenteve që vijnë nga jashtë shtetit për dërgim brenda terriotrit të tij, kjo Konventë nuk do të cenojë këto dispozita.

Neni 20

Kjo Konventë nuk do të ndalojë një marrëveshje midis dy ose më shumë Shteteve Kontraktuese për të përjashtuar:

a) nevojën për dy kopje të dokumenteve të transmetuara siç kërkohet nga paragrafi i dytë i nenit 3;

b) kërkesat gjuhësore të paragrafit të tretë të neneve 5 dhe 7;

c) dispozitat e paragrafit të katërt të nenit 5;

d) dispozitat e paragrafit të dytë të nenit 12.

Neni 21

Secili Shtet Kontraktues, në kohën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit apo aderimit ose në një datë të mëvonshme, do të informojë Ministrinë e Jashtme të Hollandës në lidhje me sa më poshtë:

a) caktimin e autoriteteve, sipas neneve 2 dhe 18;

b) caktimin e një autoriteti kompetent për të plotësuar certifikatën sipas nenit 6;
c) caktimin e një autoriteti kompetent për të marrë dokumente të transmetuara me rrugë konsullore, sipas nenit 9.

Po ashtu, secili Shtet Kontraktues do të informojë Ministrinë, sipas rastit, në lidhje me:

a) kundërshtimin ndaj përdorimit të metodave të transmetimit sipas neneve 8 dhe 10;
b) deklaratat sipas paragrafit të dytë të nenit 15 dhe paragrafit të tretë të nenit 16;
c) të gjitha modifikimet e përcaktimeve, kundërshtimeve dhe deklaratave të mësipërme.

Neni 22

Kur edhe palët e kësaj Konvente janë palë në një ose në të dyja Konventat mbi Procedurën Civile të nënshkruara në Hagë më 17 korrik 1905 dhe më 1 mars 1954, kjo Konventë do të zëvendësojë si midis tyre nenet 1 deri në 7 të Konventave të mëparshme.

Neni 23

Kjo Konventë nuk do të cenojë zbatimin e nenit 23 të Konventës mbi Procedurën Civile të nënshkruar në Hagë më 17 korrik 1905 ose të nenit 24 të Konventës mbi Procedurën Civile të nënshkruar në Hagë më 1 mars 1954.

Megjithatë, këto nene zbatohen vetëm nëse përdoren metodat e komunikimit, të njëjta me ato të parashikuara në këto Konventa.

Neni 24

Marrëveshjet plotësuese midis Palëve në Konventat e vitit 1905 dhe 1954 do të konsiderohen si njësoj të zbatueshme në këtë Konventë, përveç rasteve kur palët kanë rënë dakord ndryshe.

Neni 25

Pa cenuar dispozitat e neneve 22 dhe 24, kjo Konventë nuk do të devijojë nga Konventat që përmbajnë dispozitat mbi çështjet e udhëhequra nga kjo Konventë në të cilat, Shtetet Kontraktuese janë ose do të bëhen Palë.

Neni 26

Kjo Konventë është e hapur për t'u firmosur nga shtetet anëtare të përfaqësuara gjatë sesionit të dhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Kjo Konventë do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Neni 27

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit siç parashikohet në paragrafin e dytë të nenit 26.

Konventa do të hyjë në fuqi për çdo shtet palë që e ratifikon atë në një datë të mëvonshme në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit përkatës të ratifikimit.

Neni 28

Çdo Shtet që nuk është përfaqësuar gjatë sesionit të shtatë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private mund të aderojë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenin 27, paragrafi i parë.

Instrumenti i aderimit do të depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Konventa do të hyjë në fuqi për këtë Shtet, nëse asnjë nga Shtetet të cilat e kanë ratifikuar atë përpara depozitimit të instrumentit të aderimit nuk paraqesin ndonjë kundërshtim pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta në lidhje me këtë aderim brenda gjashtë muajsh nga data e njoftimit të tyre prej kësaj Ministrie për këtë aderim.

Në mungesë të një kundërshtimi të tillë, Konventa do të hyjë në fuqi për këtë Shtet aderues në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e periudhës më të fundit të përmendur në paragrafin e mësipërm.

Neni 29

Në momentin e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, çdo shtet mund të deklarojë shtrirjen e pasojave të kësaj Konvente, në të gjithë territorin që ai përfaqëson në nivel ndërkombëtar, apo në një ose disa prej tyre. Kjo deklaratë do të hyjë në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të Konventës në atë shtet.

Në vazhdimësi, për çdo shtrirje të kësaj natyre do të njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Konventa do të hyjë në fuqi për territoret e përmendura në këtë zgjerim në ditën e gjashtëdhjetë pas njoftimit të përmendur në paragrafin e mësipërm.

Neni 30

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi për një periudhë pesëvjeçare nga dita e hyrjes në fuqi të saj në përputhje me nenin 27 paragrafi i parë edhe përsa i përket shteteve që e kanë ratifikuar ose kanë aderuar në të në një datë të mëvonshme.

Në rast se nuk ka pasur asnjë denoncim, Konventa do të rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet.

Çdo denoncim do të njoftohet të paktën 6 muaj përpara skadimit të periudhës pesëvjeçare pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Denoncimi mund të jetë i kufizuar në një territor ose territore të caktuara në të cilat zbatohet Konventa.

Denoncimi do të ketë efekt vetëm përsa i përket shtetit i cili e ka bërë atë. Konventa do të qëndrojë në fuqi për shtetet e tjera palë.

Neni 31

Ministria e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta i njofton shteteve palë të përmendura në nenin 26, si dhe shteteve që kanë aderuar në përputhje me nenin 28, sa më poshtë:

- a) Çdo nënshkrim dhe ratifikim të përmendur në nenin 26;
- b) Datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 27 paragrafi i parë;
- c) Çdo aderim të përmendur në nenin 28 dhe datën në të cilën hyn në fuqi;
- d) Çdo zgjerim të parashikuar në nenin 29 dhe datën në të cilën hyn në fuqi;
- e) Çdo caktim, kundërshtim dhe deklaratë të përmendur në nenin 21;
- f) Çdo denoncim të parashikuar në nenin 30 paragrafi i tretë.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht, nënshkruajnë këtë Konventë.

Bërë në Hagë më 15 nëntor 1965 në dy gjuhë, anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet njësoj autentike, të lidhura në një kopje të vetme, e cila depozitohet në Arkivat e Qeverisë së Vendeve të Ulëta, prej të cilës një kopje e vërtetuar i dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike çdo shteti të përfaqësuar në Sesionin e Dhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

[N.B. Më 25 tetor 1980 Sesioni i katërbëdhjetë miratoi një rekomandim për informacionin që duhet të shoqërojë njoftimin dhe dorëzimin e dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare jashtë shtetit (Actes et documents de la Quatorzième session (1980), Tome I, Matière diverses, p. 1-67; idem, Tome IV, Entraide judiciaire, p. 339; Udhëzues praktik mbi veprimin e Konventës së Hagës së 15 nëntorit 1965 për njoftimin dhe dorëzimin e dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore jashtë shtetit në fushën civile dhe tregtare)]

**FORMULARËT (KËRKESA DHE CERTIFIKATA)
PËRMBLEDHJE E DOKUMENTIT QË DO TË DËRGOHET
(Shtojcat e parashikuara në nenet 3, 5, 6 dhe 7)
SHTOJCA NË KONVENTË
Formularë
KËRKESA PËR DËRGIM JASHTË SHETIT TË DOKUMENTEVE GJYQËSORE
DHE JASHTËGJYQËSORE**

Konventa për Njoftimin dhe Dorëzimin Jashtë Shtetit të Dokumenteve Gjyqësore dhe Jashtëgjyqësore në Fushën Civile dhe Tregtare, nënshkruar në Hagë më 15 nëntor 1965.

Identiteti dhe Adresa e
adresa autoritetit
e aplikantit marrës

Aplikanti i nënshkruar ka nderin të transmetojë - në dy kopje- dokumentet e listuara më poshtë dhe, në përputhje me nenin 5 të Konventës së sipërpërmendur, kërkon dërgim të menjëhershëm të një kopjeje të kësaj te marrësi, d.m.th.

(identiteti dhe adresa.....)

a) në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (a) të paragrafit të parë të nenit 5 të Konventës*

b) në përputhje me metodën e mëposhtme specifike (nënparagrafi (b) i paragrafit të parë të nenit 5) *

c) më anë të dërgimit te marrësi, nëse ai e pranon atë vullnetarisht (paragrafi i dytë i nenit 5) *

Autoritetit i kërkohet të kthejë ose t'i ketë kthyer aplikantit një kopje të dokumenteve- dhe të shtojcave* - me një certifikatë siç parashikohet në anën e prapme.

Lista e dokumenteve

.....
.....
.....
.....
.....

Bërë në.....

Firma dhe/ ose vula

* Fshij nëse është e papërshtatshme
Ana e prapme e kërkesës

CERTIFIKATË

Autoriteti i nënshkruar ka nderin të vërtetojë, në përputhje me nenin 6 të Konventës.

1) që dokumenti është dërguar*

o data

.....

o (vendi, rruga, numri)

.....
.....

- në një prej metodave të mëposhtme të autorizuara sipas nenit 5:

a) në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (a) të paragrafit të parë të nenit 5 të Konventës*.

b) në përputhje me metodën specifike të mëposhtme*:

.....
.....

c) me anë të dërgimit ndaj marrësit, i cili e ka pranuar atë vullnetarisht*.

Dokumentet e referuara në kërkesë i janë dërguar:

o (identiteti dhe përshkrimi i personit)

.....
.....

o Marrëdhënia me marrësin (familja, biznesi ose të tjera):

o.....

.....
.....

2) që dokumenti nuk është dërguar për arsyet e mëposhtme*:

.....
.....

Në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 12 të Konventës, aplikantit i kërkohet të paguajë ose rimbursojë shpenzimet e detajuara në deklaratën bashkëlidhur*.

Shtojca

Dokumentet e kthyera:.....

.....
.....

Në rastet e përshtatshme, dokumentet që vërtetojnë dërgimin:

.....
.....

Bërë në.....

Firma dhe/ose vula

*Fshij nëse është e papërshtatshme

PËRMBLEDHJE E DOKUMENTIT QË DO TË DËRGOHET

Konventa mbi Dërgimin jashtë Shtetit të Dokumenteve Gjyqësore dhe

Jashtëgjyqësore në Çështjet Civile ose Tregtare,

Nënshkruar në Hagë, më 15 nëntor 1965.

(neni 5 paragrafi i katërt)

Emri dhe adresa e autoritetit kërkues:

.....
.....

Informacion të detajuar për palët*:

.....
.....

DOKUMENTI GJYQËSOR**

Natyra dhe qëllimi i dokumentit:

.....

.....
Natyra dhe qëllimi i procedimeve dhe, kur duhet, sasinë në fjalë:

.....
Data dhe vendi për paraqitjen**:

.....
Gjykata që ka dhënë vendimin**:

.....
Data e vendimit **:

.....
Afatet e deklaruara në dokument **:

.....
DOKUMENTI JASHTËGJYQËSOR**

Natyra dhe qëllimi i dokumentit:

.....
Afatet e deklaruara në dokument**:

L I G J
Nr. 9555, datë 8.6.2006

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS EUROPIANE “PËR STATUSIN LIGJOR TË
PUNËTORËVE MIGRANTË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa Europiane “Për statusin ligjor të punëtorëve migrantë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4939, datë 27.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

HYRJE

Vendet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të kësaj Konvente;

duke mbajtur në konsideratë faktin se vizioni i Këshillit të Europës është të arrijë një unitet më të madh midis vendeve anëtare të tij, me qëllim ruajtjen dhe realizimin e idealeve dhe parimeve që janë trashëgimi e përbashkët, lehtësimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, si dhe respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

duke pasur parasysh që statusi ligjor i punëtorëve migrantë të cilët janë shtetas të vendeve anëtare të Këshillit të Europës duhet të standardizohet në mënyrë që të sigurohet trajtimi sa më mirë i tyre dhe me kushte jo më të këqija sesa punëtorët shtetas të vendeve pritëse në të gjitha aspektet e jetesës dhe standardeve të punës;

duke qenë të vendosur për të lehtësuar më tej zhvillimin shoqëror të punëtorëve migrantë dhe të pjesëtarëve të familjeve tyre;

duke pranuar se të drejtat dhe privilegjet që këto vende u japin shtetasve të njëri-tjetrit janë përcaktuar në bazë të marrëdhënieve më të ngushta që i bashkojnë vendet anëtare të Këshillit të Europës nëpërmjet statusit të tij,

janë marrë vesh për sa vijon.

KREU I

Neni 1

Përkufizime

1. Në përputhje me qëllimet e kësaj konvente, termi “Punëtor migrant” do të nënkuptojë një shtetas të një pale kontraktuese, i cili është autorizuar nga një tjetër palë kontraktuese për të qëndruar në territorin e vet, në mënyrë që të punësohet në këmbim të një pagese.

2. kjo Konventë nuk do të zbatohet:

a) për punonjësit e kufirit;

b) për artistët dhe persona të ngjashëm me ta, për sportistët e punësuar për një kohë të shkurtër, si dhe për profesionistët e lirë;

c) për marinarët;

d) për personat në proces kualifikimi;

e) për punëtorët sezonalë; punëtorët migrantë sezonalë janë ata të cilët, duke qenë shtetas të njëres nga palët kontraktuese, janë të punësuar mbi bazën e një kontrate në territorin e një pale tjetër kontraktuese në një veprimtari për një periudhë të caktuar apo për një punë të caktuar që varet nga ritmi i sezonit;

f) për punëtorët që janë shtetas të njëres palë kontraktuese, të cilët bëjnë një punë të caktuar në territorin e një pale tjetër kontraktuese për llogari të një sipërmarrjeje, e cila ka zyrën e vet të regjistruar jashtë territorit të asaj pale kontraktuese.

KREU II

Neni 2

Format e rekrutimit

1. Rekrutimi i punëtorëve të ardhshëm migrantë mund të kryhet nëpërmjet kërkesave nominative ose jonominative dhe, në rastin e fundit, do të kryhet me ndërmjetësinë e autoritetit zyrtar të shtetit të origjinës, nëse ekziston një autoritet i tillë, dhe aty ku është e përshtatshme, me ndërmjetësinë e autoritetit zyrtar të shtetit pritës.

2. Kostot administrative të rekrutimit, të hyrjes dhe vendosjes në shtetin pritës, nuk do të përballohen nga punëtori i ardhshëm migrant në rast se këto veprime kryhen nga një autoritet zyrtar.

Neni 3

Analizat mjekësore dhe provimi i aftësisë

1. Rekrutimi i punëtorëve migrantë mund të paraprihet prej analizave mjekësore dhe provimit të aftësisë.

2. Analizat mjekësore dhe provimi i aftësisë kanë për qëllim të përcaktojnë nëse punëtori i ardhshëm migrant është i aftë fizikisht dhe mendërisht dhe i kualifikuar teknikisht për punën që i është ofruar ai dhe të sigurojnë që gjendja e tij shëndetësore nuk përbën asnjë rrezik për shëndetin publik.

3. Masat për kompensimin e shpenzimeve që lidhen me analizat mjekësore dhe provimet e aftësisë do të përcaktohen në përputhje me marrëveshjet dypalëshe për të siguruar që këto shpenzime të mos bien mbi punëtorin e ardhshëm migrant.

4. Një punëtori migrant, të cilit i është bërë një ofertë pune nominative nuk do t'i kërkohet të hyjë në një provim aftësie, përveç rastit ku dyshohet për mashtrim, si dhe rastit kur për këtë gjë është paraqitur një kërkesë nga vetë punëdhënësi.

Neni 4

E drejta për të dalë nga një territor; e drejta për të hyrë në një territor; formalitetet administrative

1. Çdonjëra nga palët kontraktuese do t'u garantojë të drejtat e mëposhtme punëtorëve migrantë:

- të drejtën për të dalë nga territori i palës kontraktuese, shtetas të së cilës ata janë;
- të drejtën për të hyrë në territorin e një pale kontraktuese për t'u punësuar pasi të jenë autorizuar dhe pasi të kenë marrë dokumentet e nevojshme për ta bërë këtë gjë.

2. Këto të drejta do jenë subjekt kufizimesh, të parashikuara në ligj, në rast cenimi të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit publik, si dhe të moralit publik.

3. Dokumentet që i kërkohen punëtorit migrant për emigrim apo imigrim do të lëshohen sa më shpejt të jetë e mundur dhe pa pagesë apo kundrejt pagesës së një shume e cila nuk e kalon koston administrative të tyre.

Neni 5

Formalitetet dhe procedura në lidhje me kontratën e punës

Çdo punëtor migrant i pranuar për punësim do të pajiset para nisjes për në shtetin pritës me një kontratë punësimi ose me një ofertë të përcaktuar punësimi, çdonjëra prej të cilave mund të paraqitet në një ose disa prej gjuhëve që përdoren në shtetin e origjinës ose në ose disa prej gjuhëve që përdoren në shtetin pritës. Përdorimi i njërës nga gjuhët e përdorura në shtetin e origjinës dhe njërës nga gjuhët e përdorura në shtetin pritës do të jetë e detyrueshme në rastin e rekrutimit nga një autoritet zyrtar ose nga një zyrë punësimi e njohur zyrtarisht.

Neni 6

Informacioni

1. Palët kontraktuese do të shkëmbejnë dhe do t'u sigurojnë migrantëve të ardhshëm informacionin e duhur për rezidencën, kushtet dhe mundësitë e bashkimit familjar, natyrën e punës, mundësinë e lidhjes së një kontrate të re pune në përfundim të kontratës së parë, kualifikimet e nevojshme, kushtet e punës dhe të jetesës (përfshi dhe koston e jetesës), pagesën, sigurimet shoqërore, banesën, ushqimin transferimin e kursimeve, udhëtimin dhe zbritjet nga pagesa për sigurimet shoqërore dhe për mbrojtjen shoqërore, taksat dhe detyrimet e tjera. Gjithashtu mund të sigurohet informacion edhe për kushtet kulturore dhe fetare të shtetit pritës.

2. Në rastin e punësimit nëpërmjet një autoriteti zyrtar të shtetit pritës, ky informacion do të sigurohet përpara nisjes në një gjuhë që punëtori i ardhshëm migrant mund ta kuptojë, për ta ndihmuar atë të marrë një vendim bazuar në njohjen e plotë të fakteve. Përkthimi i këtij informacioni, atëherë kur është e nevojshme, në një gjuhë që punëtori i ardhshëm migrant mund ta kuptojë, do të bëhet, si rregull i përgjithshëm, nga shteti i origjinës.

3. Çdonjëra nga palët kontraktuese do të ndërmarrë masat e duhura për të parandaluar propagandën e gabuar në lidhje me emigrimin dhe imigrimin.

Neni 7 **Udhëtimi**

1. Çdonjëra nga palët kontraktuese do të marrë përsipër që, në rast rekrutimi zyrtar kolektiv, kostoja e udhëtimit për në shtetin pritës të mos përballohet në asnjë mënyrë nga punëtori migrant. Mënyra e pagesës do të përcaktohet në një marrëveshje dypalëshe që mund t'i shtrijë këto efekte edhe për familje dhe për punëtorët e rekrutuar individualisht.

2. Në rastin e punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre që udhëtojnë transit në territorin e një pale kontraktuese me destinacion shtetin pritës apo në kthim për në shtetin e origjinës, autoritetet kompetente të shtetit ku do të bëhet transiti do të ndërmarrin të gjitha masat për të shpejtuar udhëtimin e tyre dhe për të shmangur vonesat dhe vështirësitë administrative.

3. Çdonjëra nga palët kontraktuese do të çlirohet nga detyrimet dhe taksat e importit gjatë hyrjes në shtetin pritës, gjatë transitit dhe gjatë kthimit përfundimtar në shtetin e origjinës për:

a) sendet personale dhe pasuritë e luajtshme të punëtorëve migrantë dhe të pjesëtarëve të tjerë që i përkasin familjeve të tyre; dhe/ose

b) një sasi të arsyeshme veglash dhe pajisjesh pune të punëtorëve migrantë të nevojshme për punën të cilën do të fillojnë.

Përrjashtimet e përmendura më sipër do të kryhen në përputhje me ligjin e brendshëm apo rregullat e shteteve për të cilat bëhet fjalë.

KREU III

Neni 8 **Leja e punës**

1. Çdonjëra nga palët kontraktuese, që lejon një punëtor migrant të hyjë në territorin e saj për të punuar, do të lëshojë apo rinovojë për të një leje pune (me përjashtim të rastit kur ai përjashtohet nga kjo kërkesë) në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin e vet.

2. Megjithatë, leja e punës e lëshuar për herë të parë nuk e kufizon punëtorin që të qëndrojë detyrimisht tek i njëjti punëdhënës apo në të njëjtin rajon për një periudhë kohe më të gjatë se një vit.

3. Rinovimi i lejes së punës së punëtorit migrant, si rregull, do të bëhet për një periudhë kohe të paktën 1-vjeçare, nëse gjendja aktuale dhe zhvillimi i pritshëm i situatës së punësimit në atë vend e mundëson këtë gjë.

Neni 9 **Leja e qëndrimit**

1. Çdonjëra nga palët kontraktuese do t'i japë lejeqëndrimi punëtorëve migrantë të autorizuar të punojnë në territorin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë Konventë në rast se kjo kërkohet nga legjislacioni i brendshëm i palës.

2. Leja e qëndrimit do të jepet në përputhje me legjislacionin e vendit dhe, nëse është e nevojshme, do të rinovohet për një periudhë që, si rregull, është të paktën sa kohëzgjatja e lejes së punës.

Kur leja e punës është me kohëzgjatje të papërcaktuar, leja e qëndrimit do të lëshohet dhe, në rast se është e nevojshme, do të rinovohet për një periudhë të paktën 1-vjeçare. Leja do të lëshohet dhe rinovohet pa pagesë apo kundrejt pagesës së një shume e cila nuk e kalon koston administrative të tyre.

3. Masat e përcaktuara në këtë nen do të zbatohen edhe për pjesëtarët e familjeve të punëtorëve migrantë të autorizuar për t'iu bashkuar atyre në përputhje me nenin 12 të kësaj Konvente.

4. Nëse një punëtor migrant është i papunë për shkak të paftësisë, rrjedhojë e një sëmundjeje, një aksidenti, dëshirës apo vullnetit të tij të lirë, subjekt i konfirmimit zyrtar nga autoritetet kompetente, ky do të lejohet të qëndrojë në territorin e shtetit pritës për një periudhë kohe jo më pak se 5 muaj në përputhje me nenin 25 të kësaj Konvente. Megjithatë asnjë nga palët kontraktuese, në rastin e nënparagrafit të mësipërm, nuk është e detyruar t'a lejojë punëtorin migrant të qëndrojë për një periudhë kohe më të gjatë sesa periudha e pagesës së papunësisë.

5. Leja e qëndrimit, e lëshuar në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1-3 të këtij neni, mund të hiqet:

a) për arsye që lidhen me sigurinë kombëtare në përputhje, politikën kombëtare apo moralin publik;

b) nëse mbajtësi i lejes refuzon, pasi është njoftuar për pasojat e këtij refuzimi, t'u nënshtrohet masave që janë përcaktuar për të nga një autoritet zyrtar mjekësor për mbrojtjen e shëndetit publik;

c) nëse një kusht thelbësor për lëshimin apo për vlefshmërinë e lejes nuk është përmbushur. Megjithatë çdonjëra nga palët kontraktuese merr përsipër t'i garantojë punëtorit migrant, të cilit i është hequr leja, të drejtën e apelit pranë autoritetit përkatës gjyqësor apo administrativ, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm.

Neni 10

Pritja

1. Pas mbërritjes në shtetin pritës, punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre do t'u jepet i gjithë informacioni, këshillat përkatës, si dhe asistenca e nevojshme për vendosjen dhe përshtatjen e tyre.

2. Për këtë qëllim punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre do t'u jepet ndihmë dhe asistencë nga shërbimet sociale të shtetit pritës ose prej organizmave që punojnë për interesin publik në shtetin pritës dhe ndihmë nga autoritetet konsullore të shtetit të tyre të origjinës. Veç kësaj, punëtorëve migrantë do t'u sigurohen nga autoritetet e punësimit kushte të njëjta për ndihmë dhe asistencë me ato të punëtorëve vendas. Megjithatë, çdonjëra nga palët kontraktuese do të përpiqet të sigurojë mundësimin e shërbimeve sociale të posaçme, atëherë kur kjo të jetë e nevojshme, për të lehtësuar apo për të bashkërenduar pritjen e punëtorëve migrantë dhe të familjeve të tyre.

3. Çdonjëra prej palëve kontraktuese merr përsipër të sigurojë që punëtorët migrantë dhe familjet e tyre të mund të ushtrojnë lirisht besimin në përputhje me fenë e tyre; çdonjëra nga palët kontraktuese do ta lehtësojë ushtrimin e këtij besimi brenda mundësive të veta.

Neni 11

Pagimi i shpenzime të detyrueshme për mbajtjen e personave në ngarkim

1. Statusi i punëtorëve migrantë nuk do të përplasë me detyrimin e punëtorit migrant për pagimin e shpenzimeve për kujdesin apo mbajtjen e personave të tjerë në shtetin e origjinës, që burojnë nga lidhjet familjare farefisnore, martesore apo të ngjashme, përfshi këtu edhe detyrimin për mbajtjen e një fëmije të jashtëligjshëm

2. Çdonjëra nga palët kontraktuese do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar pagimin e këtyre detyrimeve duke iu përshtatur sa më shumë të jetë e mundur formës së miratuar nga Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës.

3. Brenda mundësive të veta, çdonjëra nga palët kontraktuese do të ndërmarrë hapa për të caktuar një autoritet të vetëm për të pranuar dhe shpërndarë aplikimet për pagimin e shpenzimeve të përcaktuara në paragrafin 1 më lart.

4. Ky nen nuk do të ketë pasoja mbi marrëveshjet ekzistuese apo të ardhshme dypalëshe apo shumëpalëshe.

Neni 12

Bashkimi familjar

1. Bashkëshorti/ja i punëtorit migrant të punësuar ligjërisht në territorin e njëres palë kontraktuese dhe fëmijët e pamartuar që konsiderohen të mitur nga legjislacioni përkatës i shtetit pritës, në varësi të punëtorit migrant, kanë të drejtë të bashkohen me punëtorin migrant në territorin e palës kontraktuese, me kusht që kjo e fundit të ketë mundësi strehimi për familjen me kushte të njëjta me ato të punëtove vendas në zonën ku punëtori migrant është i punësuar, sipas dispozitave që përcakton kjo Konventë dhe në përputhje me procedurën e pranimit të përcaktuar nga legjislacioni përkatës apo nga marrëveshjet ndërkombëtare. Çdo palë kontraktuese mund ta kushtëzojë dhënien e autorizimit me një periudhë pritjeje që nuk duhet të jetë më e gjatë se 12 muaj.

2. Çdo shtet mundet që në çdo kohë, me anën e një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, e cila hyn në fuqi një muaj pas datës së marrjes prej tij, t'i referohet paragrafit 1 në lidhje me bashkimin familjar të kushtëzuar nga mjetet e mjaftueshme të punëtorit migrant për të plotësuar nevojat e familjes së tij.

3. Çdo shtet mundet që në çdo kohë, me anën e një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës e cila hyn në fuqi një muaj pas datës së marrjes prej tij, të tërhiqet përkohësisht nga detyrimi për dhënien e autorizimit që përcakton paragrafi 1, për një ose disa pjesë të territorit që do të përcaktohen në atë deklaratë, me kusht që këto masa të mos krijojnë përplasje me detyrimet që rrjedhin prej instrumenteve të tjera ndërkombëtare. Deklarata do të përmbajë arsyet e veçanta të tërheqjes nga detyrimi, arsye që lidhen me kapacitetin pritës.

4. Çdo shtet që ndërmerr masën e tërheqjes nga detyrimi do të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për masat që ka marrë dhe do të sigurojë që këto masa të bëhen sa më shpejt publike. Ai gjithashtu do të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës kur këto masa nuk zbatohen më dhe kushtet e Konventës nisin sërish të zbatohen plotësisht.

5. Tërheqja nga detyrimi nuk do të zbatohet, si rregull, për kërkesat për bashkim familjar që u janë bërë autoriteteve përkatëse përpara deklaratës së adresuar te Sekretari i Përgjithshëm nga punëtorët migrantë të vendosur tashmë në pjesën e territorit për të cilën bëhet fjalë.

Neni 13

Strehimi

1. Çdo palë kontraktuese do të bëjë të mundur për punëtorët migrantë kushte strehimi dhe qiraje jo më të këqija sesa ato të punëtorëve vendas në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse.

2. Çdo palë kontraktuese do të bëjë të mundur që autoritetet kompetente kombëtare të bëjnë inspektime në bashkëpunim me autoritetet përkatëse konsullore, duke vepruar brenda kompetencave të tyre, për t'u siguruar që standardet e strehimit të punëtorëve migrantë të jenë të barabarta me ato të punëtorëve vendas.

3. Çdo palë kontraktuese do të marrë përsipër të mbrojë punëtorët migrantë nga shfrytëzimi për sa i përket qirasë, në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj për këtë çështje.

4. Çdo palë kontraktuese do t'u sigurojë punëtorëve migrant, me mjetet që kanë në dispozicion autoritetet kombëtare, një strehim të përshtatshëm.

Neni 14

Parakualifikimi, shkollimi, kualifikimi gjuhësor, kualifikimi dhe rikualifikimi profesional

1. Punëtorët migrantë dhe pjesëtarët e familjeve të tyre të pranuar zyrtarisht në territorin e një pale kontraktuese do të kryejnë, mbi të njëjtën bazë dhe në të njëjtat kushte me ato të punëtorëve vendas, arsimin e përgjithshëm dhe kualifikimin dhe rikualifikim profesional dhe do të kenë mundësinë të ndjekin arsimin në një nivel më të lartë në përputhje me rregullat e përgjithshme që rregullojnë pranimin në institucionet përkatëse të shteteve pritëse.

2. Për të nxitur futjen në shkolla të përgjithshme dhe profesionale dhe në qendrat e kualifikimit profesional, shteti pritës do të lehtësojë mësimin e gjuhës së tij ose, nëse atje përdoren disa gjuhë, njërën prej gjuhëve për punëtorët migrantë dhe pjesëtarët e familjeve të tyre.

3. Për zbatimin e paragrafëve 1 dhe 2 të përcaktuar më lart, e drejta e shkollimit do të lihet në kompetencën e secilës palë kontraktuese, e cila do të bëjë për përpjekjet për t'u mundësuar fëmijëve të punëtorëve migrantë të cilët jetojnë me familjet e tyre në shtetin pritës- në përputhje me masat e përcaktuara nga neni 12 i kësaj Konvente - të njëjtat lehtësira si edhe vendasve.

4. Kualifikimet e mëparshme të punëtorit si diplomat dhe kualifikimet profesionale të marra në shtetin e origjinës do të njihen nga çdo palë kontraktuese në përputhje me marrëveshjet dypalëshe apo shumëpalëshe.

5. Palët kontraktuese, duke vepruar në bashkëpunim të ngushtë, do të përpiqen për të siguruar që skemat e trajnimit dhe ritrajnimit profesional, brenda kontekstit të këtij neni, të plotësojnë sa më shumë të jetë e mundur nevojat e punëtorëve migrantë duke konsideruar kthimin e tyre në shtetin e origjinës.

Neni 15

Mësimi i gjuhës amtare të punëtorit migrant

Palët kontraktuese do të ndërmarrin veprime në bazë marrëveshjes të përbashkëta për të mundësuar, sa më shumë që të jetë e mundur, kurse të veçanta për fëmijët e punëtorëve migrantë për mësimin e gjuhës amtare për të lehtësuar kthimin e tyre në shtetin e origjinës.

Neni 16

Kushtet e punës

1. Për sa u përket kushteve të punës, punëtorët migrantë të autorizuar për të punuar do të trajtohen në mënyrë jo më pak të favorshme sesa punëtorët vendas në përputhje me masat legjislative apo administrative, me marrëveshjet e punësimit kolektiv apo konventat.

2. Parimi i trajtimit të barabartë i përcaktuar në paragrafin e mësipërm nuk mund të shmanget nëpërmjet përdorimit të kontratave individuale.

Neni 17

Transferimi i kursimeve

1. Çdo palë kontraktuese do të lejojë, në përputhje me marrëveshjet e përcaktuara nga legjislacioni i saj, transferimin e plotë apo të pjesshëm të fitimeve apo të kursimeve të punëtorëve migrantë sipas dëshirës së tyre.

2. Kjo masë do të zbatohet gjithashtu edhe për shumat të cilat punëtori migrant i detyrohet personave të tjerë. Transferimi i shumave për mbajtjen e personave të tjerë në ngarkim në shtetin e origjinës nuk do të ndalohet apo parandalohet në asnjë mënyrë.

3. Çdo palë kontraktuese do të lejojë, mbi bazën e marrëveshjeve dypalëshe apo me anën e mjeteve të tjera, transferimin e shumave që u detyrohet ende punëtorëve migrantë kur ata largohen nga territori i shtetit pritës.

Neni 18 **Sigurimet shoqërore**

1. Çdo Palë Kontraktuese do të marrë përsipër brenda territorit të saj trajtimin e barabartë të punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre me vendasit për çështjen e sigurimeve shoqërore, në bazë të kushteve të kërkuara nga legjislacioni vendas dhe marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe tashmë të përfunduara apo që do të përfundohen ndërmjet palëve përkatëse kontraktuese.

2. Palët kontraktuese do të përpiqen gjithashtu t'u sigurojnë punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre ruajtjen e të drejtave të fituara apo në proces fitimi, si edhe të përfitimeve të tjera jashtë shtetit, nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe.

Neni 19 **Asistenca sociale dhe mjekësore**

Çdo palë kontraktuese merr përsipër t'u japë asistencë sociale dhe mjekësore punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre, të cilët qëndrojnë ligjërisht brenda territorit të saj njësoj si shtetasve të vet, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare dhe në veçanti nga Konventa Europiane për Asistencë Sociale dhe Mjekësore e vitit 1953.

Neni 20 **Aksidentet industriale dhe sëmundjet profesionale, higjiena industriale**

1. Duke synuar parandalimin e aksidenteve industriale dhe sëmundjeve profesionale si dhe higjienën industriale, punëtorët migrantë do të përfitojnë të njëjtat të drejta dhe mbrojtje si punëtorët vendas, në zbatim të ligjeve të një pale kontraktuese dhe marrëveshjeve kolektive dhe duke pasur parasysh situatat e veçanta.

2. Një punëtor migrant, i cili është viktimë e një aksidenti industrial apo ka marrë një sëmundje profesionale në territorin e shtetit pritës, do të përfitojë rehabilitim profesional në të njëjtat kushte si ato të punëtorëve vendas.

Neni 21 **Kontrolli i kushteve të punës**

Çdo palë kontraktuese do të kontrollojë ose do të krijojë mundësinë për kontrollin e kushteve të punës së punëtorëve migrantë njësoj si edhe për punëtorët vendas. Një kontroll i tillë do të bëhet nga organizmat apo institucionet përkatëse të shtetit pritës dhe nga çdo autoritet tjetër i autorizuar për këtë gjë nga shteti pritës.

Neni 22 **Vdekja**

Çdo palë kontraktuese do të kujdeset, brenda kuadrit të saj ligjor dhe, nëse është nevoja, brenda kuadrit të marrëveshjeve dypalëshe, që të ndërmerren hapa për të siguruar asistencën e nevojshme për transportimin në shtetin e origjinës të trupave të punëtorëve migrantë të cilët kanë vdekur si rezultat i një aksidenti industrial.

Neni 23

Tatimi mbi të ardhurat

1. Në lidhje me të ardhurat dhe pa paragjykuar masat e marra për tatimin e dyfishtë që përfshihen në marrëveshjet që janë përfunduar ose që mund të përfundohen në të ardhmen ndërmjet palëve kontraktuese, punëtorët migrantë nuk do të mbajnë përgjegjësi në territorin e një pale kontraktuese, për detyrime, taksa apo kontribute më të mëdha sesa ato që aplikohen për vendasit në të njëjtat rrethana. Në veçanti, punëtorët migrantë do të kenë të drejtën e zbritjes apo përjashtimit nga taksat të të gjitha shumave të paguara si detyrime të caktuara, përfshi ato për mbajtjen e personave në ngarkim.

2. Palët kontraktuese do të vendosin bashkërisht masat që duhet të merren për të shmangur tatimin e dyfishtë mbi të ardhurat e punëtorëve migrantë me anën e marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe.

Neni 24

Mbarimi i kontratës dhe largimi nga puna

1. Me mbarimin e një kontrate pune të lidhur për një periudhë të caktuar kohe, në fund të periudhës së caktuar dhe në rastin e prishjes së kësaj kontrate apo prishjes së një kontrate pune të lidhur për një periudhë të papërcaktuar kohe, punëtorët migrantë do të trajtohen në një mënyrë jo më pak të favorshme sesa trajtimi që u bëhet punëtorëve vendas në zbatim të ligjit vendas ose marrëveshjeve kolektive të punësimit.

2. Në rast largimi individual apo kolektiv nga puna, punëtorët migrantë do të trajtohen në mënyrë të njëjtë me punëtorët vendas, në përputhje me ligjin vendas ose me marrëveshjet kolektive të punësimit për sa u përket formave dhe periudhës së paralajmërimit, shpërblimin e garantuar për këtë sipas ligjit ose marrëveshjeve siç mund të jetë rasti i prishjes pa paralajmërim të kontratave të tyre të punës.

Neni 25

Ripunësimi

1. Nëse një punëtor migrant e humbet punën për arsye që nuk varen prej tij, si sëmundje të shpeshta apo për një periudhë të gjatë kohe, autoriteti kompetent i shtetit pritës do të lehtësojë ripunësimin e tij në përputhje me ligjet dhe rregullat e atij shteti.

2. Për këtë qëllim shteti pritës do të marrë masat e nevojshme për të siguruar, sa më shumë të jetë e mundur, rikualifikimin profesional dhe rehabilitimin në punë të punëtorit migrant në fjalë, nëse ai synon të vazhdojë të jetë i punësuar në këtë shtet.

Neni 26

E drejta për t'u drejtuar në gjykatë dhe pranë autoriteteve administrative në shtetin pritës

1. Çdo palë kontraktuese do t'u sigurojë punëtorëve migrantë trajtim jo më pak të favorshëm në lidhje me procedurat ligjore. Punëtorëve migrantë do t'u jepet, me të njëjtat kushte si edhe vendasve, mbrojtje e plotë ligjore dhe gjyqësore e personit, e të drejtave dhe e interesave të tyre; në mënyrë të veçantë ata do të kenë, në të njëjtën mënyrë si edhe vendasit, të drejtën të drejtohen në autoritetet kompetente gjyqësore dhe administrative në përputhje me ligjin e shtetit pritës, si dhe të drejtën për të pasur asistencën e kujtdo personi që ata do të zgjedhin, i cili është i kualifikuar sipas ligjeve të atij shteti, për shembull në mosmarrëveshjet me punëdhënësit, me pjesëtarët e familjeve apo me të tretët. Dispozitat e së drejtës private dhe asaj ndërkombëtare të shtetit përkatës nuk do të preken nga ky nen.

2. Çdo palë kontraktuese do t'u sigurojë punëtorëve migrantë asistencë ligjore në të njëjtat kushte si shtetasve të vet dhe, në rast çështjesh civile apo penale, mundësinë e ndihmës më përkthyes nëse ata nuk kuptojnë apo flasin gjuhën e përdorur në gjykatë.

Neni 27

Përdorimi i shërbimeve të punësimit

Çdo palë kontraktuese njih të drejtën e punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre të pranuar zyrtarisht në territorin e saj të përdorin shërbimet e punësimit me të njëjtat kushte si punëtorët vendas sipas praktikave ligjore, rregulloreve dhe praktikave administrative përfshi edhe kushtet e pranimit, që janë në fuqi në atë shtet.

Neni 28

Ushtrimi i së drejtës për t'u organizuar

Çdo palë kontraktuese do t'u lejojë punëtorëve migrantë të drejtën të organizohen për mbrojtjen e interesave të tyre ekonomike dhe shoqërore në kushte të njëjta me ato që përcakton ligji vendas për shtetasit e vet.

Neni 29

Pjesëmarrja në veprimtaritë e sipërmarrjes

Çdo palë kontraktuese do të lehtësojë sa më shumë të jetë e mundur pjesëmarrjen e punëtorëve migrantë në veprimtaritë e sipërmarrjes në të njëjtat kushte si punëtorëve vendas.

KREU IV

Neni 30

Kthimi

1. Çdonjëra palë kontraktuese do të marrë masat e duhura, për aq sa është e mundur, për të ndihmuar punëtorët migrantë dhe familjet e tyre në rastin e kthimit të tyre në shtetin e origjinës dhe në veçanti masat që lidhen me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të kësaj Konvente. Marrja e masave për ndihmë financiare është e drejtë e secilës palë kontraktuese.

2. Për të bërë të mundur që punëtorët migrantë të vihen në dijeni para se të ndërmarrin udhëtimin e kthimit për kushtet në të cilat do të mund të risistemohen në shtetin e origjinës, ky shtet do të komunikojë me shtetin pritës, i cili do të vërë në dispozicion të atyre që kërkojnë, informacione që në veçanti kanë të bëjnë me:

- mundësitë dhe kushtet e punësimit në shtetin e origjinës;
- ndihmën financiare që jepet për riintegrim ekonomik;
- ruajtjen e të drejtave të sigurimeve shoqërore që kanë përfituar jashtë shtetit;
- hapat që duhen ndërmarrë për të lehtësuar akomodimin e tyre;
- njohjen e kualifikimeve profesionale që janë marrë jashtë shtetit dhe provimet që duhen dhënë për të siguruar njohjen e tyre zyrtare;
- njohjen e kualifikimeve arsimore, që fëmijët e punëtorëve migrantë të mund të pranohen në shkollë pa u ulur në nivel.

KREU V

Neni 31

Ruajtja e të drejtave të fituara

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet sikur justifikon trajtimin më pak të favorshëm sesa ai që gëzojnë punëtorët migrantë nga legjislacioni i shtetit pritës apo nga marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, palë e të cilave është shteti në fjalë.

Neni 32

Lidhjet ndërmjet kësaj konvente dhe ligjeve të palëve kontraktuese apo marrëveshjeve ndërkombëtare

Masat e kësaj Konvente nuk do të paragjykojnë dispozitat e ligjeve të palëve kontraktuese apo të traktateve dypalëshe apo shumëpalëshe, konventave, marrëveshjeve etj., si edhe hapat e ndërmarra për t'i zbatuar ato, të cilat janë në fuqi ose mund të hyjnë në fuqi, dhe në zbatim të të cilave u është dhënë ose do t'u jepet trajtim më i favorshëm personave që mbrohen nga Konventa.

Neni 33

Zbatimi i Konventës

1. Një komitet konsultativ do të ngrihet brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente.
2. Çdo palë kontraktuese do të caktojë një përfaqësues në Komitetin Konsultativ. Çdo vend tjetër i Këshillit të Evropës mund të përfaqësohet nga një vëzhgues me të drejtë fjale.
3. Komiteti Konsultativ do të shqyrtojë çdo propozim që i paraqitet nga njëra prej palëve kontraktuese për të lehtësuar ose përmirësuar zbatimin e Konventës si edhe propozimet që bëhen për amendimin e saj.
4. Mendimet dhe rekomandimet e Komitetit Konsultativ do të pranohen me shumicën e anëtarëve të Komitetit, ndërsa propozimet për amendimin e Konventës do të pranohen unanimisht nga të gjithë anëtarët e komitetit.
5. Mendimet, rekomandimet dhe propozimet e Komitetit Konsultues për sa më sipër do t'i adresohen Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës që do të vendosë për vendimin që do të merret.
6. Komiteti Konsultativ do të thirret nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës dhe do të mblidhet, si rregull, të paktën çdo dy vjet dhe veç kësaj kurdo që të paktën dy palë kontraktuese ose Komiteti i Ministrave e kërkon këtë. Komiteti do të mblidhet gjithashtu me kërkesën e një pale kontraktuese kur zbatohen masat e përcaktuara nga paragrafi 3 i nenit 12.
7. Komiteti Konsultativ do t'i hartojë periodikisht Komitetit të Ministrave një raport që do të përmbajë informacion mbi ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e palëve kontraktuese në lidhje me çështjet që trajton kjo Konventë.

KREU VI

Neni 34

Firmosja, ratifikimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për t'u firmosur nga vendet anëtare të Këshillit të Europës, subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi. Instrumentet e ratifikimit, pranimi apo miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
2. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pas datës së depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit, pranimi apo miratimit.
3. Për sa i përket ratifikimit, pranimi apo miratimit nga një shtet që e ka firmosur, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi apo miratimit.

Neni 35

Shtrirja territoriale

1. Çdo shtet mundet që, në kohën kur firmos apo kur depoziton instrumentin e ratifikimit, pranimi apo miratimit në një datë të mëvonshme, me anën e një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente tek të gjithë apo një pjesë nga territori i vet për lidhjet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës ose në emër të të cilit është i autorizuar të ndërmarrë nisma.

2. Çdo deklaratë e bërë në vijim të paragrafit pararendës në lidhje me territorin e përmendur në deklaratë mund të tërhiqet. Kjo tërheqje do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pasi deklarata e tërheqjes merret nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 36 **Rezervat**

1. Çdo palë kontraktuese mundet që në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit apo miratimit të shprehë një ose disa rezerva lidhur me jo më shumë se nëntë nene të kapitujve II deri IV përveç nene 4, 8, 9, 12, 16, 17, 20, 25, 26.

2. Çdo palë kontraktuese mundet që në çdo kohë të tërheqë pjesërisht ose plotësisht rezervat e shprehura në përputhje me paragrafin pararendës me anën e një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës që do të hyjë në fuqi që nga data e marrjes prej tij.

Neni 37 **Denoncimi i Konventës**

1. Çdo palë kontraktuese mund ta denoncojë këtë Konventë me anën e një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës që do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes prej tij.

2. Asnjë denoncim s'mund të bëhet brenda pesë viteve nga data e hyrjes në fuqi të konventës në lidhje me palën kontraktuese në fjalë.

3. Çdo palë kontraktuese e cila s'do jetë më anëtare e Këshillit të Europës s'do të jetë më palë në këtë Konventë gjashtë muaj pas datës kur humbet cilësinë e të qenit anëtare e Këshillit të Europës.

Neni 38 **Njoftimet**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i njoftojë shtetet anëtare të Këshillit:

- a) për çdo firmosje;
- b) për çdo depozitim instrumenti ratifikimi, pranimi apo miratimi;
- c) për çdo njoftim të marrë në lidhje me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 12;
- d) për çdo datë hyrjeje në fuqi të kësaj Konventë në përputhje me nenin 34 të saj;
- e) për çdo deklaratë të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 35;
- f) për çdo rezervë të shprehur në përputhje me masat e paragrafit 1 të nenit 36;
- g) për çdo tërheqje të rezervave në përputhje me masat e përcaktuara nga paragrafi 2 i nenit 36;
- h) për çdo njoftim të marrë në përputhje me masat e nenit 37 dhe për datën kur bëhet padia.

Në dëshmi të sa mësipërm, nënshkruarit, të autorizuar posaçërisht për këtë qëllim, kanë firmosur këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, më 24 nëntor 1977, në një origjinal të vetëm në gjuhët frënge dhe angleze të dy tekstet njëlloj të besueshme që do të depozitohen në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u dërgojë nga një kopje të vërtetuar secilit nga shtetet nënshkruese.

L I G J
Nr. 9556, datë 8.6.2006

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË PËR
REALIZIMIN E PROGRAMIT “REHABILITIMI I PORTIT TË VLORËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit “Rehabilitimi i Portit të Vlorës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4940, datë 27.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT “REHABILITIMI
I PORTIT TË VLORËS”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Qeveria e Republikës Italiane, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, më poshtë të quajtura “Palë Kontraktuese”;

duke pasur parasysh:

se në Protokollin trevjeçar të bashkëpunimit 2002-2004, Qeveria italiane ka marrë përsipër të financojë një iniciativë për rehabilitimin e portit ekzistues të Vlorës dhe për përmirësimin e funksionimit të tij, duke dhënë për këtë qëllim një ndihmë prej 15.000.000 euro kredi dhe prej 300.000 euro grant;

se gjatë mbledhjes së datës 8 qershor 2004, Komiteti Drejtues i Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) ka dhënë pëlqimin për dhënien e një ndihme prej 15.000.000 euro kredi dhe prej 300.000 euro grant, për realizimin e ndërhyrjes “Rehabilitimi i Portit të Vlorës”, më poshtë i quajtur Programi,

në lidhje me sa më sipër,

Palët Kontraktuese janë marrë vesh për sa vijon.

Neni 1

Qëllimi dhe pjesët përbërëse të Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të rregullojë detyrimet e ndërsjella të të dyja Palëve Kontraktuese për zbatimin sa më korrekt të Programit, duke i referuar në mënyrë të veçantë procedurave të vlerësimit të kontratave, si dhe të procedurave të menaxhimit/prejardhjes/ lëvrimit të fondeve të kredisë së ndihmës.

Kjo Marrëveshje përbëhet nga 15 nene dhe nga 3 shtojca bashkëngjitur, të renditura më poshtë, që janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje:

1. Përmbledhja e programit;
2. Tenderat e shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve (kushtet e veçanta);
3. Mënyrat e zbatimit dhe të administrimit të kredisë së ndihmës.

Neni 2

Objektivat e Programit

Objektivi i përgjithshëm i Programit është të kontribuojë në planin kombëtar të përforcimit të infrastrukturave të punëve publike, transportit detar dhe të favorizojë zhvillimin ekonomik të vendit, në veçanti të zonës së Vlorës.

Objektivi specifik i Programit është zhvillimi i veprimtarisë së portit të Vlorës, përmes rehabilitimit dhe realizimit të veprave detare dhe krijimit të shërbimeve më të mira për shoqëritë lundrimit dhe pasagjerit, duke i dhënë kështu një impuls tregtisë dhe veprimtarive lokale edhe në aspektin e punësimit.

Neni 3

Përshkrimi i Programit

Programi është përshkruar shkurtimisht në shtojcën 1 dhe parashikohet të arrijë rezultatet e mëposhtme:

- Realizimi i një porti të efektshëm që disponon: a) një mol për ankorimin e anijeve tregtare; b) një mol për ankorim për anijet e pasagjerëve; c) të gjitha shërbimet tokësore të përshtatshme për të lehtësuar ankorimin e anijeve, veprimtarinë e ngarkim-shkarkimit, magazinimit dhe zhdoganimit të mallrave;

- Shkurtimi i kohës së pritjes së anijeve për ankorim dhe veprimet në tokë.

Zbatimi i Programit përmban:

- Veprimtari paraprake inxhinierike, që do të realizohen me një kredi ndihmë, për verifikimet dimensionale të projekteve ekzistuese, për përgatitjen e dokumenteve të tenderit për dhënien në sipërmarrje të shërbimeve inxhinierike të përshkruara në pikën në vijim;

- Shërbime inxhinierike për projektin ekzekutiv dhe mbikëqyrjen e punimeve, që do të realizohet me financim në formën e kredisë së ndihmës dhe do t'u jepet nëpërmjet procedurave të tenderit, shoqërive italiane.

- Ndërhyrja kryesore e përbërë nga punime rehabilitimi dhe ndërtimi, që do të realizohet me financim në formën e kredisë së ndihmës dhe do t'u jepet nëpërmjet procedurave të tenderit shoqërive italiane.

- Aktiviteti i monitorimit qoftë gjatë nisjes së tenderit, ashtu dhe gjatë zbatimit të punimeve, që do të realizohet me financim përmes një kredie ndihme.

Neni 4

Institucionet e përfshira në realizimin e Programit

Institucionet e përfshira në realizimin e Programit janë si më poshtë:

Për Palën italiane:

a) MPJ/DPBZH (Ministria e Punëve të Jashtme/ Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim), e cila do të sigurojë lëvrimin e burimeve financiare për kredinë sipas modaliteteve të parashikuara nga dispozitat ligjore italiane në fuqi, të treguara në mënyrë të përmbledhur në këtë Marrëveshje. MPJ/DPBZH, në bashkëpunimin me Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT), do të ketë përveç të tjerash edhe detyrën për të monitoruar ecurinë e Programit dhe mundësinë e tij për të arritur rezultatet e cituara në nenin 3. MPJ/DPBZH do të veprojë nëpërmjet zyrave kompetente për zbatimin e detyrave të saj. Në veçanti, Njësia Teknike Qendrore e MPJ/DPBZH më poshtë e quajtur NJTQ, do të sigurojë të gjitha funksionet e natyrës teknike në mbështetje të realizimit të Programit.

b) ARTIGIANCASSA, e cila-nën drejtimin MPJ/DPBZH dhe të Ministrisë së Ekonomisë Italiane-do të nënshkruajë me Ministrinë e Financave të Shqipërisë (MF), një marrëveshje financiare, që do të rregullojë përdorimin e fondeve të kredisë së ndihmës. Në kuadrin e Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur, ARTIGIANCASSA do të kujdeset për zbatimin e kontratave të veçanta për lëvrimin e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, përmes të cilave do të realizohen veprimtaritë e parashikuara në Program. Ajo do të merret gjithashtu edhe me sigurimin e pagesave të shumave të kontratave të organizmave zbatues.

c) Ambasada/NJTQ në Tiranë, e cila do të sigurojë të gjitha funksionet e natyrës teknike të nevojshme për sigurimin e ecurisë korrekte të veprimtarive. Në kuadër të funksioneve të veta institucionale, Ambasada/NJTQ do të sigurojë kontaktet e nevojshme me palët e Programit, duke u kujdesur ndër të tjera për marrjen dhe përcjelljen e të gjithë dokumentacionit zyrtar.

Për Palën shqiptare:

a) MPPTT, e cila do të sigurojë zbatimin e detyrimeve që dalin nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë dhe strukturat e tjera kompetente shqiptare (në veçanti Drejtorinë e Portit të Vlorës).

b) MF, e cila do të nënshkruajë Marrëveshjen Financiare me ARTIGIANCASSA dhe do të kujdeset për kontaktet operative me këtë të fundit, ashtu si është saktësuar në Marrëveshjen Financiare.

c) Banka vepruese në Shqipëri që do të mbajë kontaktet e punës me Artigiancassa-n dhe funksionet e përshkruara në shtojcën 3, pjesa III, pikat 3 dhe 4.

d) PIU e ngritur pranë MPPTT, e cila do të merret me koordinimin e funksioneve të natyrës teknike dhe drejtuese të nevojshme për realizimin e Programit.

Neni 5

Burimet financiare dhe modalitetet e përdorimit të kredisë së ndihmës

Burimet financiare të nevojshme për realizimin e Programit janë si më poshtë:

1. Kredi ndihme në shumën prej 15.000.000 euro për realizimin e të gjitha veprimtarive të parashikuara në Program;

2. Fond grant prej 300.000 euro për:

- veprimtaritë e verifikimit të projekteve ekzistuese dhe redaktimit të termave të referencës për përzgjedhjen e shoqërisë italiane të konsulencës, së cilës do t'i besohen shërbimet e inxhinierisë (Projekti ekzekutiv dhe supervizioni i punimeve);

- monitorimin e veprimtarisë gjatë zbatimit të veprës;

Afatet dhe kushtet e kredisë së ndihmës janë si më poshtë:

- Periudha e rimbursimit të kredisë: 39 vjet

- Periudha e faljes (pa pagesë principali): 19 vjet

- Përqindja e interesit: 0,00%

Në bazë të procedurave në fuqi pranë MPJ/DPBZH, hapat kryesorë për t'u ndërmarrë, për përdorimin e fondit të kredisë së ndihmës janë si vijon (të specifikuar më mirë në shtojcën 3):

1. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje;

2. Nxjerrja nga ana e Ministrisë së Ekonomisë Italiane të një dekreti ministror, që autorizon ARTIGIANCASSA-n për të negociuar dhe firmosur Kontratën Financiare me MF;

3. Firmosja e Kontratës Financiare ndërmjet ARTIGIANCASSA dhe MF;

4. Kryerja e tenderit për dhënien e shërbimeve inxhinierike (projektim dhe supervizim i punimeve);

5. Përgatitja, nga ana e shoqërisë së inxhinierisë, e dokumenteve të tenderit për zbatimin e punimeve;

6. Kryerja e tenderit për dhënien e kontratës së punimeve.

Për procedurat e tenderit në pikat 4 dhe 6 do të kryhet verifikimi i përputhshmërisë nga ana e MPJ/DPBZH, që në rast përfundimi pozitiv, do t'i japë "s'ka vërejtje" (*no objection*) MPPTT-së, për firmosjen e kontratave.

Kontratat e miratuara nga MPJ/DPBZH do të jenë në ngarkim të Marrëveshjes Financiare me modalitetet e lëvrimit të fondeve të treguara në shtojcën 3.

Neni 6

Monitorimi i Programit

Ecuria e Programit do të monitorohet bashkërisht nga MPJ/DPBZH (përmes misioneve periodike të funksionarëve dhe ekspertëve të caktuar sipas nevojës) dhe nga MPPTT-së. Të dyja Palët angazhohen, që tani, të përcaktojnë të gjitha masat që do të shihen të nevojshme në rast se, gjatë zbatimit të Programit, skema e treguesve nuk do të respektohet apo nuk do të konsiderohet më e përshtatshme për kushtet sektoriale dhe lokale.

Neni 7

Modalitetet e përfitimit të shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve

Përcaktimi i zbatuesve të veprimtarive të Programit do të kryhet përmes hapjes së tenderave të disiplinuar nga dispozitat që përmban manuali i procedurave (i përshtatur nga Komisioni Europian më 23 dhjetor 2002) mbi: "Tenderat e shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve në kuadër të bashkëpunimit komunitar dhe vendet e treta", si edhe nga sa është përcaktuar në shtojcën 2.

Neni 8

Detyrimet e Qeverisë italiane

Qeveria italiane merr përsipër të garantojë financimin:

- deri në 15.000.000 euro, si kredi ndihmë, që do të bëhet i disponueshëm pranë ARTIGIANCASSA-s dhe do të lëvrohet siç është përcaktuar në shtojcën 3;

- deri në 300.000 euro, në formë granti, që do të menaxhohet direkt nga MPJ/DPBZH, si dhe nga Ambasada/NJTQ.

Neni 9

Detyrimet e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë merr përsipër:

- të vërë në dispozicion burimet financiare që ka në kompetencë, të barazvlefshme me 3.000.000 euro ose monedhë të ngjashme;

- të ndërmarrë të gjitha veprimet, veprimtaritë dhe aktet formale të domosdoshme për zbatimin me sukses të Programit;

- të bashkëpunojë me MPJ/DPBZH për veprimtaritë e monitorimit të Programit, sipas nenit 6, dhe për krijimin e aksesit në dokumentacionin ekzistues dhe në zonat e veprimtarisë.

Neni 10

Dispozitë antikorrupsion

Qeveria italiane është impenjuar në luftën kundër korrupsionit në të gjitha format që ai mund të shfaqet.

Në veçanti, me qëllim që të shmanget çdo rast veprimtarie e paligjshme apo parregullsie në rastet e prezantimit të ofertave për furnizime, shërbime dhe vepra ndërtimore, Qeveria italiane ka futur, për të gjithë pjesëmarrësit në tender, detyrimin e nënshkrimit dhe paraqitjes së një pakti integriteti (Integrity Pact), bashkëngjitur me ofertat e tyre apo kontratat e miratuara. Mungesa e paraqitjes së këtij pakti integriteti do të sjellë përjashtimin në mënyrë automatike nga tenderi, dhe mungesa e respektimit të tij gjatë zbatimit të kontratës së miratuar do të sjellë zbatimin sanksioneve të rëndësishme, të parashikuara në të. Futja e kësaj dispozite ka për qëllim sigurimin e një konkurrence korrekte dhe mundësive të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit në tender, si edhe një zbatim korrekt dhe transparent të kontratës së miratuar.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje midis Palëve Kontraktuese lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet, për aq sa është e mundur, nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave.

Neni 12

Pengesat dhe forca madhore

Në rast të pengimit të realizimit të programit për shkak të forcave madhore (luftë, përmytje, zjarr, tufan, tërmetet, konflikte pune, greva, masa qeveritare, vështirësi të paparashikuara në transport dhe shkaqe të tjera) të pranuar nga të dyja Palët, ose në rast rreziku, apo kushte të rrezikshme për personelin e huaj, do të zbatohen dispozitat në vijim, të bazuar në rekomandimet e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe të miratuara nga MPJ/DPBZH.

a) Në rast se kohëzgjatja e pengimit të realizimit të Programit është më pak se 6 (gjashtë) muaj, përdorimi i fondeve të papërdorura do të pezullohet, derisa MPJ/DPBZH të autorizojë rifillimin e veprimtarive;

b) Në rast se kohëzgjatja e pengesës është më shumë se 6 (gjashtë) muaj dhe më pak se 24 (njëzet e katër) muaj, Programi pezullohet dhe fondet e papërdorura do të mbahen derisa të mos ketë më pengesa dhe të merret autorizimi i MPJ/DPBZH për rifillimin e punimeve.

c) Në rast se kohëzgjatja e pengesës është më e madhe se 24 (njëzet e katër) muaj, Palët duhet të bihen dakord për vazhdimësinë e programit dhe të përcaktojnë rrjedhën e veprimeve. Në rast se është i pamundur vazhdimi i veprimtarisë, Palët duhet të vendosin për destinacionin e fondeve të papërdorura.

Neni 13

E drejta e zgjidhjes së Marrëveshjes së MPJ/DPBZH

MPJ/DPBZH ruan të drejtën e tërheqjes nga Marrëveshja në rastet e mëposhtme:

a) Mosrealizimi i veprimtarive të parashikuara në program për arsye që nuk kanë të bëjnë me Palën italiane;

b) Pengesa të vazhdueshme ose forca madhore në bazë të nenit 11, si më sipër;

Në të dyja rastet e sipërpërmendura, MPJ/DPBZH mund të vendosë unanimisht përfundimin e Marrëveshjes, duke njoftuar MPPTT dhe MF përmes një note verbale të paktën 3 muaj përpara. Në çdo rast, pas një njoftimi të tillë, MPPTT do të ndërpresë veprimtarinë e Programit, përveç kur Palët bien dakord ndryshe.

Neni 14

Ndryshimet

Palët mund të propozojnë ndryshime të përmbajtjes së kësaj Marrëveshjeje me anë të shkëmbimit të notave verbale nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Ndryshimet apo shtesat e bëra në këtë mënyrë dhe të rëna dakord ndërmjet Palëve, do të hyjnë në fuqi me anë të procedurave përkatëse të parashikuara.

Neni 15

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe denoncimi

Marrëveshja në fjalë do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet, me të cilat Palët Kontraktuese do të komunikojnë zyrtarisht përfundimin e procedurave të brendshme respektive të parashikuara për këtë qëllim.

Kjo Marrëveshje ka një kohëzgjatje prej tre vjetësh dhe do të rinovohet automatikisht për periudhat në vijim me kohëzgjatje të njëjtë.

Kjo Marrëveshje mund të denoncohet në çdo kohë dhe denoncimi do të hyjë në fuqi vetëm gjashtë muaj pasi të njoftohet Pala tjetër Kontraktuese.

Në dëshmi të sa më sipër, përfaqësuesit nënshkruer, të autorizuar posaçërisht nga qeveritë e tyre respektive, nënshkruan këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 19.4.2006 në dy origjinale, secila në gjuhët shqip dhe italisht. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën italiane do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
ITALIANE

Ministri i Punëve Publike, Transportit
dhe Telekomunikacionit
Lulëzim Basha

Ambasadori italian në Tiranë
Attilio Massimo Iannucci

SHTOJCA 1 PËRMBLEDHJA E PROGRAMIT

1. Përshkrimi

Programi parashikon realizimin e veprave detare dhe civile pranë portit, të cilat do të krijojnë mundësitë për realizimin e një rehabilitimi të thellë dhe rrënjësor të strukturave ekzekutuese, me modernizimin e plotë të pajisjeve të portit. Me qëllim që të vihet në jetë realizimi i veprave të sipërpërmendura, parashikohen gjithashtu të kryhen edhe veprimtari të nevojshme inxhinierike.

Shuma e përgjithshme e kredisë italiane prej 15 milion euro përfshin një shumë prej 14 milion euro për punime dhe furnizime dhe një shumë prej 1 milion euro për veprimtari inxhinierike.

Komponenti i fundit grant, që do të administrohet drejtpërdrejt nga DPBZH ka qëllim, ashtu si do të shpjegohet më mirë në vazhdim, për veprimtari paraprake konsulente (0,2 milion euro) dhe për verifikim (0,2 milion euro).

Vepra detare për t'u realizuar janë ato të parashikuara në "Masterplanin e përmirësimit të portit të Vlorës" – faza 1 dhe 2A complete (Vepra detare) dhe vepra civile janë pjesë e atyre që janë të parashikuara në fazën 3 të këtij masterplani.

1.1 Realizimet (Komponenti i kredisë)

A) Veprat detare

Parashikohet realizimi i dy moleve të rinj, për trafikun civil (tragete) dhe një për anijet e mallrave (kargo), përveç kësaj furnizimi me disa pajisje për portin.

A.1 Moli i ri Ferry (për tragetet):

Moli i ri ka një gjatësi prej rreth 120 m dhe është i përbërë nga një soletë betonarmeje me bazament mbi shtylla çeliku. Vetëm përsa i përket molit, do të kryhet rimodelimi i disa spondeve (parapetë) me vënie në vend të disa brigjeve (gumave) shkëmbore mbrojtëse.

Kategoritë kryesore të punimeve dhe sasitë përkatëse rezultojnë:

- thellim i fundit të detit deri në thellësi 7.5 m me heqjen e rreth 143 000 m³ materiali të shkrifët;
- realizimi, ngritje terrenesh me rreth 39 000 m³ me material të thatë për rimodelimin e mbrojtjes së spondave, prej të cilave 22 000 m³ guma;
- realizimi i strukturës së molit me hedhje të rreth 2 600 m³ betonarmeje;
- realizimi i një pahije për themelet, të përbërë nga shtylla çeliku Ø 762 mm, me gjatësi mesatare prej 36 m, gjithsej 4 775 m;
- shtrim me asfalt, gjithsej 9 500 m³.

A.2 Moli i ri kargo

Moli i ri kargo, me përmasa prej 108 m me 20 m, është i përbërë nga një soletë betonarmeje me bazament të mbështetur në shtylla çeliku. Moli do të realizohet përbri gumës ekzistuese mbrojtëse. Kategoritë kryesore të punimeve dhe sasitë përkatëse rezultojnë:

- realizim ngritje terrenesh me rreth 25 000 m³ me materiale të thatë për zhvendosjen dhe për mbrojtjen e spondave, prej të cilave 11 000 m³ gumë mbrojtëse;
- realizimi i strukturës së molit me hedhje të rreth 3 000 m³ betonarme;
- realizimi i një pahije për themelet, të përbëra nga shtylla çeliku Ø 762 mm, me gjatësi mesatare prej 37 m, gjithsej 5 500 m;
- shtrim me asfalt, gjithsej 8 000 m²;
- vepra drenazhimi;

Për “Molin e ri Ferry” dhe “Molin e ri kargo” ekziston tashmë Projekti përkatës i zbatimit (Final Design-Dec.98/June 99 Phase 1 e 2A), që i përfshin planet e skicuara dhe specififikimet teknike. Në këtë rast rezulton e nevojshme të azhurnohen vetëm dokumentet e sipërmarrjes që do të hartohen sipas direktivave europiane (Direktivave 23/12/2003).

B) Veprat civile dhe furnizimet

Veprat civile kanë të bëjnë me realizimin e veprave në tokë, për mbështetjen e aktiviteteve të portit. Veprat do të realizohet në hapësirën që i takon portit të Vlorës, i cili shtrihet me një sipërfaqe prej rreth 4,0 ha.

Veprat e parashikuara mund të përmbliidhen në këtë mënyrë:

- shtrim me asfalt të pjesëve të sipërfaqeve që kanë të bëjnë me portin;
- realizimi i dy ndërtesave për doganën (rreth 260 dhe 400 m²);
- realizimi i ofiçinës/magazinë (900 m²);
- rrethime dhe hyrje (rreth 1 500m);
- furnizim në vendin e montimit me dy vinça me binarë;
- furnizim në vendin e montimit me një peshore në nivelin e rrugës.

Për këto vepra, nuk ekzistojnë projektet e zbatimit, por vetëm projektet paraprake në nivel studimi fisibiliteti; është parashikuar që këto hartohen nga shoqëria inxhinierike, e cila do të bëjë kryesisht rishikimin e projektit të zbatimit të portit, të specifikimeve teknike dhe të dokumenteve të tenderit, për realizimin Projektit.

Instalimet e parashikuara të nevojshme për të garantuar sigurinë doganore, lokalet e spedicionit dhe të magazinimit të mallrave të pazhdoganuara, repartet doganore, instalimet për peshimin, etj., duhet të kryhen edhe sipas udhëzimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për kontrollin dhe aprovimin.

1.2 Veprimtaritë e konsulencës dhe veprimtaritë e inxhinierisë (projekti dhe supervizioni i punimeve)

A) Veprimtaritë e konsulencës (Komponent i grantit)

Projekti i përgjithshëm i veprave të portit, i realizuar disa vite më parë nga GIBB Maritime, dhe që jepet nga autoritete shqiptare, është në bazë të ndërhyrjeve të parashikuara. Duke pasur parasysh kohën që ka kaluar, është e nevojshme të kryhen disa studime të hollësishme në lidhje me të dhënat bazë, veçanërisht për aspektet e mëposhtme:

Thellësia, sektori rrethor i erërave të rrezikshme dhe lartësia e dallgëve, prirja e baticave në gji dhe transporti solid, gjeologjia dhe aspekti sizmik i zonës, duke përdorur për këtë të fundit, të dhënat sizmike të azhurnuara të marra në Shqipëri dhe Itali.

Me qëllim që të lejohen veprimtaritë paraprake të nevojshme për nisjen e Projektit, është parashikuar që të merren masa që t'i besohet konsulentëve dhe shoqërive konsulente për të kryer:

i) Kontrolltet tekniko-dimensionale të projekteve ekzistuese;

ii) Përpunimi e dokumenteve të tenderit për përzgjedhjen e shoqërisë inxhinierike për veprimtaritë sipas pikës së mëposhtme 3.1.3.B). Tenderit, siç saktësohet më mirë në vazhdim, duhet të shqyrtohet nga autoritete shqiptare kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe e Telekomunikacioneve), dhe i rezervohet shoqërive italiane me përvojë përsa i përket çështjeve të porteve.

B) Aktivitetet inxhinierike (Komponent i kredisë)

Nga ana e shoqërisë inxhinierike, që do të zgjidhet sipas tenderit për të cilin u fol në pikën ii), do të kryhen veprimtaritë e mëposhtme:

i) rishikimi i projekteve të zbatimit, të veprave detare;

ii) përpunimi i projekteve të zbatimit të veprave civile dhe përpunimi i specifikimeve teknike për furnizimet, sipas pikës së mëparshme 3.12;

iii) përgatitja e dokumenteve të tenderit për shoqërinë zbatuese dhe për furnizimet;

iv) zbatimi, në fazën e realizimit, të veprimtarive të nevojshme të kontrollit dhe të drejtimit të punimeve, në përputhje me normativën në fuqi.

2. Kohëzgjatja e ndërhyrjes

Ndërhyrja e financuar me kredi ndihmë do të ketë një kohëzgjatje prej 26 muajsh.

Gjatë periudhës së parë 6-mujore, do të zbatohen veprimtaritë përgatitore të sipërmarrjes (kushtet e kontratës së tenderit), që do të financohet me grant.

3. Plani i shpenzimeve dhe derdhja e shumave

Burimet e financimit italian mund të përdoren në mënyrë ekskluzive për të kryer aktivitetet e parashikuara nga kjo Marrëveshje. Rishpërndarja dhe rregullimet ndërmjet zërave të veçantë të parashikuar për realizimet (Veprat detare, veprat civile) dhe për veprimtaritë e inxhinierisë (Supervizion dhe Projekti i zbatimit), të parashikuara në tabelën 1, në rritjen ose në zvogëlimin brenda një vlere maksimale prej 20% dhe, sido që të jetë, pa ndryshuar vlerën e përgjithshme, mund të bëhen nga enti zbatues. Përkundrazi, ndryshime më të mëdha se 20% duhet t'i nënshtrohen aprovimit të Qeverisë italiane.

4. Në ngarkim të Palës shqiptare do të jenë:

a) kostot që kanë të bëjnë me blerjen e terreneve pasuri shtetërore, shpronësime të mundshme, të drejtat për hyrë në to dhe garancitë;

b) kostot e administrimit të Projektit, për logjistikë (zyra, komunikacione, transporte);

c) përjashtimi nga taksat dhe tatimet;

d) detyrimet të mundshme më të mëdha për gjëra të paparashikuara dhe ndryshim çmimesh.

Për asnjë arsye, fondet e financimit italian nuk mund të përdoren për të paguar taksat lokale, detyrimet doganore apo TVSH. Furnizimet dhe shërbimet e rëndësishme në lidhje me realizimin e Projektit do të jenë të lira nga çdo taksë apo tatim doganor shqiptar.

5. Raporti përfundimtar (RP)

RP do të paraqitet nga Enti i Portit të Vlorës në fund të Projektit, do t'i nënshtrohet aprovimit të MPPTT dhe pastaj do t'i dërgohet MPJ/DPBZH. RP do të ketë strukturë të përgjithshme: i) përmbledhjen e përmbajtjes së Projektit; ii) përshkrimin e mënyrës së zbatimit të Projektit (tenderat, kalendarin, raportet, realizimet dhe ndryshimet, kostot, financimin, rezultatet e arritura nga ndërmarrjet dhe enti zbatues); iii) rezultatet e arritura nga Projekti (operative, institucionale dhe financiare); iv) ndikimet (ekonomike, shoqërore, mjedisore); v) pranueshmëria e Projektit; vi) rezultatet e arritura DPBZH dhe Qeveria; vii) rezultatet globale të arritura; viii) përfundime dhe rekomandime.

6. Kostot e Programit (në ngarkim të bashkëpunimit italian)

Në tabelën e mëposhtme janë të përmbledhura, në mënyrë përshkruese, kostot e vlerësuara të zërave të veçantë.

Tab.1 Kuadri i përgjithshëm i kostove të vlerësuara të “Programit”

I- Punime të përgjithshme	1- Shpenzime paraprake për instalimin e kantierit dhe të përgjithshme	Totali (Euro) 1.000.000
Punime detare	2- Thellim dhe lëvizje toke 3- Veshje e gumës 4- Molo dhe themele 5- Rrugë dhe shtrime	8.000.000
Punime civile	6- Ndërtesa dhe rrugë 7- Pajisje porti	4.400.000
Ditë pune	8- Ditë pune	600.000
Nëntotal 1		14.000.000
2. Supervizioni i punimeve & projekti i detajuar final i punimeve civile		1.000.000
Supervizioni i punimeve dhe projekti i detajuar final	1- Ekspertët Ndërkombëtarë 2- Ekspertët lokalë 3- Akomodimi i Ekspertëve Ndërkombëtarë 4- Fluturime ndërkombëtare	
Nëntotali 2		1.000.000
Investimi i total punime – Kredia e ndihmës		15.000.000
Investimi total, përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe monitorimi – Granti		300.000
		15.300.000

SHTOJCA 2
TENDERAT E SHËRBIMEVE, FURNIZIMEVE DHE PUNIMEVE
(KUSHTET E VEÇANTA

Kjo shtojcë i referohet përdorimit të kredisë së ndihmës italiane.

Dhënia e kontratave do të kryhet nëpërmjet tenderave të hapura, të rezervuara vetëm për shoqëri italiane, përqindja e kredisë së ndihmës e përdorshme për kosto lokale dhe/ose për vende drejt zhvillimit, nuk mund të kalojë 50% të vetë kredisë.

Për dhënien e të gjitha tenderave të parashikuara në Program, do të adaptohen procedurat e parashikuara në MANUALIN E PROCEDURAVE (i përshtatur nga Komisioni European më 23 dhjetor 2002) dhe ndryshime të tjera të mundshme që kanë të bëjnë me tenderat e shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve në kuadrin e bashkëpunimit komunitar me vendet e treta.

Në çdo rast procedura e seleksionimit duhet te përfshijë:

1. Verifikimin e përputhshmërisë së ofruesve (persona juridikë, shoqëri dhe ndërmarrje), që do të konsiderohen jo të aftë atëherë kur:

a) janë në gjendje falimentimi, likuidimi, administrimi i kontrolluar ose me preventivë të koordinuar, ndërprerje veprimtarie ose që janë objekt i një procedimi të ngjashëm i parashikuar nga ligjet dhe rregullat kombëtare;

b) janë objekt i një procedure për deklarim falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrolluar, preventiv i konkorduar ose të një procedimi të ngjashëm të parashikuar nga ligjet dhe nga rregullat kombëtare;

c) janë dënuar me vendim të prerë pa të drejtë apelimi për shkelje të etikës profesionale;

d) janë deklaruar përgjegjës për shkelje të rënda të detyrave profesionale, të provuara me elementë të çfarëdolloj dokumentacioni të administratës gjyqësore;

e) nuk kanë bërë derdhje të rregullta të detyrimit të sigurimeve shoqërore sipas dispozitave ligjore të vendit ku janë permanent;

f) nuk kanë bërë derdhje të rregullta të detyrimeve ligjore mbi taksat sipas dispozitave ligjore të vendit ku janë permanentë;

g) janë shpallur fajtorë për pasaktësi lidhur me dhënien e informacionit të kërkuar nga administrata juridike lidhur me sa më sipër;

h) janë shpallur fajtorë, për shkak të mosrespektimit të detyrimeve kontraktuale, të mos përmbushjeve të rënda në lëndën e zbatimit, në kuadër të një kontrate tjetër të nënshkruar me të njëjtën administratë juridike ose në kuadër të një kontrate tjetër të financuar nëpërmjet fondeve komunitare;

Përveç kësaj ofruesit italianë do t'u duhet të paraqesin një certifikatë ose një deklaratë të ngjashme që nuk bëjnë pjesë në kategoritë e dhëna në Dekretin Legjislativ Italian, 8 gusht 1994, nr.490 ("antimafia").

Ofruesit duhet të paraqesin, në mbështetje të ofertave të tyre, provat e duhura konform legjislacionit të vendit ku janë permanent, që vërteton se ata nuk janë ndodhur në asnjë situatat e parashikuara në pikat (a), (b), (c), (e) dhe (f).

2. Verifikimi i gjendjes ekonomike dhe financiare të ofruesve përmes:

a) një deklaratë e kapitalit social të shoqërisë dhe faturimeve në tre vitet e fundit gjatë tenderimeve;

b) një deklaratë e xhiros totale të konkurruesve, në rast të një "Joint Venture" të përkohshme, të xhiros së secilit prej pjesëmarrësve.

c) një deklaratë që tregon xhiron e sektorëve specifikë, të cilëve u referohet tenderi, ose sektori për të cilin, në rast të një bashkimi të përkohshëm shoqërisht, shoqëria individuale synon të kontribuojë;

d) një deklaratë e përshtatshme e përfaqësuesve ligjorë ose një certifikatë bankare që përmban informacion mbi marrëdhëniet me institucionet bankare me rëndësi ndërkombëtare për të demonstruar pranueshmërinë komerciale dhe financiare të konkurruesve dhe shoqërive që përbëjnë bashkimin e përkohshëm të shoqërive;

e) një certifikatë që vërteton se konkurruesi është anëtar i Dhomës së Tregtisë në vendin ku është permanent;

f) në rast të një bashkimi të përkohshëm shoqërisht, duhet të paraqitet një kopje e kontratës së asociimit që tregon shoqërinë që merr përsipër rolin e palës përgjegjëse përkundrejt MIE lidhur me zbatimin e kontratës.

3. Verifikimi i kapacitetit teknik dhe profesional të konkurruesve përmes:

a) Kopje e dokumenteve origjinale që vërtetojnë përbërjen ligjore dhe/ose selinë qendrore ose zyrën e regjistrimit dhe nëse këto të dhëna nuk përputhen, vendndodhjen e selisë qendrore të kompanisë, shoqërisë ose partneritetit, ose të pjesëve të ndryshme që përbëjnë konkurruesit, në rast të një bashkimi të përkohshëm shoqërisht;

b) Një raport që përmban dokumentacion informativ mbi precedentët e eksperiencës së punës së konkurruesve në tre vitet e fundit, dhe lidhur me tenderat e tjerë që janë duke u kryer kërkohet gjithashtu informacioni specifik rreth efektivitetit dhe pjesëmarrjes konkretet në çdo tender;

c) Kualifikimet dhe eksperiencat e stafit kyç që do të ngarkohen nga kontraktuesi për zbatimin e kontratës;

d) Një raport i shkurtër mbi veprimtarinë e konkurrentëve, të vetëm apo të asocuar, me referim specifik mbi veprimtarinë e lidhura me Programin.

Krahasimi midis konkurrentëve, mbi bazën e kritereve të vlerësimit të përcaktuara në njoftimin e kontratës do të kryhet duke përdorur kritere të caktuara dhe duke vlerësuar çmimin për identifikimin e konkurrentëve ekonomikisht më të favorizuar.

Kriteret duhet të jenë precize, jodiskriminuese dhe as paragjyquese për një konkurrim korrekt.

SHTOJCA 3 MËNYRAT E ZBATIMIT DHE TË ADMINISTRIMIT TË KREDISË SË NDIHMËS

Seksioni I. Nxjerrja e njoftimeve të tenderit, procedura aplikuese

Dokumentacioni duhet të përgatitet konform shtojcës 2, që përmend manualin e procedurave (I përshtatur nga Komisioni Europian në 23 dhjetor 2002), dhe ndryshimeve eventuale, që lidhen me: kontratat e shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve në kuadër të bashkëpunimit komunitar me Vendet e treta. Dokumentacioni në çdo rast duhet:

- të saktësojë “kushtet specifike” për çdo tender;
- të shprehë kriteret e vlerësimit që do të përdorë Komisioni i krijuar në MPPTT;

1. Përgatitja e dokumenteve të tenderit

MPTT do të përgatisë dokumentacionin e tenderit për seleksionimin e kontraktuesit (punime, supervizion punimesh) dhe do t’ia tregojë Ambasadës/NJTQ me kërkesën për të publikuar njoftimin për tenderat, në gazetata italiane.

2. Verifikimi i përputhshmërisë të dokumentacionit të tenderit

Verifikimi i përputhshmërisë me marrëveshjen aktuale do të kryhet nga MPJ/DPBZH, në bazë të përputhjes së:

- Përmbajtjeve me karakter ligjor me procedurat e dhëna në shtojcën 2;
- Specifikimeve teknike dhe parametrave të vlerësimit me objektivat që Programi propozon të arrijë.

3. Publikimi i njoftimit

Në rast të një verifikimi pozitiv, njoftimi I tenderit do të publikohet nga ana e MPJ/DPBZH në gazetata italiane, në buletin e bashkëpunimit dhe në faqen e internetit të MPJ. MPPTT do të procedojë në të njëjtën mënyrë me publikimin e njoftimeve të tenderave në gazetata kombëtare.

Seksioni II

Faza e vlerësimit – Procedura e zbatuar

1. Kontrolli i ofertave të dorëzuar për çdo tender do të kryhet nga një Komision vlerësimi i krijuar enkas nga MPPTT. Gjatë procesit të hapjes së ofertave do të marrë pjesë një përfaqësues i caktuar nga Ambasada/NJTQ në cilësinë e vëzhguesit.

2. Për çdo garë PIU do t’i transmetojë Ambasadës/NJTQ, dokumentacionin që përmban aktet e Komisionit, së bashku me kontratën për firmë, duke kërkuar miratimin për firmosjen e kontratës. Ky dokumentacion do të dërgohet nga Ambasada italiane/NJTQ tek MPJ/DPBZH, së bashku me komentet e mundshme.

3. MPJ/DPBZH do të verifikojë parimisht përputhjen ligjore dhe teknike të vlerësimeve të kryera, me procedurat dhe kriteret/ parametrat e parashikuara në dokumentet e tenderit. Mbas të jetë kryer verifikimi, MPJ/DPBZH do të informojë Ambasadën për rezultatet.

4. Në rast të një konkludimi pozitiv (nulla osta) MPPTT do të procedojë për firmosjen e kontratës me shoqëritë që do të rezultojnë fituese.

Seksioni III

Faza e dhënies së kontratave dhe lëvrimeve të fondit – procedura e zbatuar

1. Kontratat e zyrtarizuara midis shoqërive fituese dhe MPPTT duhet të dërgohen në MPJ/DPBZH nëpërmjet Ambasadës/NJTQ, së bashku me kopjen e “performance bond” dhe të miratimit të lartpërmendur, me deklaratën e impenjimit të palës shqiptare për të përballuar kostot lokale (TVSH, taksat doganore, shpronësimet, etj).

2. Mbas marrjes dhe kontrollimit të dokumentacionit, MPJ/DPBZH do të procedojë duke autorizuar ARTIGIANCASSA-n të mundësojë pagesat e kontratave në bazë të Marrëveshjes Financiare.

3. ARTIGIANCASSA do t’i kërkojë firmave italiane të interesuara një “deklaratë angazhimi” që të gjitha mallrat dhe shërbimet janë me origjinë italiane dhe që shpenzimet në vend dhe/ose në vendet e treta të industrializuara, nuk mund të kalojnë vlerën përfundimtare të çdo kontrate, si dhe një certifikatë antimafia. Kontekstualisht ARTIGIANCASSA do t’i kërkojë kredimarrësit shqiptar paraqitjen e kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve.

4. Pas marrjes së gjithë dokumentacionit të përcaktuar në pikën 3, ARTIGIANCASSA do t'i komunikojë Kredimarrësit dhe eksportuesit italian, mundësinë e fillimit të pagesave të kontratave në bazë të Marrëveshjes Financiare, si dhe mënyrën e tyre e financimit. Përfundimi i kësaj procedure do të përcaktojë datën efektive në fuqi të këtyre kontratave.

5. Derdhjet, një nga një, do të kryhen nga ARTIGIANCASSA drejtpërdrejt për eksportuesin, pas paraqitjes së dokumentacionit administrativ të parashikuar në çdo kontratë (fatura, situacioni i punimeve, etj). Pagesat mund të bëhen vetëm pas aprovimit nga ana e MPPTT.

L I G J
Nr. 9557, datë 8.6.2006

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN KUADËR PËR BASHKËPUNIMIN NDËRMJET SHTETEVE FRANKOFONE TË EUROPËS QENDRORE DHE LINDORE PËR ZHVILLIMIN E FORMIMIT PROFESIONAL DHE TEKNIK”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen kuadër për bashkëpunimin ndërmjet shteteve frankofone të Europës Qendrore dhe Lindore për zhvillimin e formimit profesional dhe teknik”, bërë në Bukuresht më 5 nëntor 2004.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4941, datë 27.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJA KUADËR
BASHKËPUNIMI MIDIS SHTETEVE FRANKOFONE TË EUROPËS QENDRORE DHE LINDORE PËR ZHVILLIMIN E FORMIMIT PROFESIONAL DHE TEKNIK

Preambul

Në kontekstin e deklaratës së ministrave europianë të formimit profesional e teknik dhe të Komisionit Europian të nënshkruar në Kopenhagen në 29 dhe 30 nëntor 2002, shtetet e vendeve frankofone të nënshkruara, të quajtura më poshtë “Palë Kontraktuese”,

- të *nxitur* nga vullneti për të forcuar lidhjet e miqësisë dhe të solidaritetit që bashkojnë popujt e Frankofonisë;

- të *ndërgjegjshëm* për domosdoshmërinë e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, anëtare ose vëzhguese, për të forcuar lidhjet e partneritetit në fushën e formimit profesional dhe teknik;

- *duke dashur* të zhvillojnë bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh në fushën e formimit profesional dhe teknik;

- lidhjet e shkëmbimit dhe bashkëpunimit midis sistemeve të formimit profesional dhe teknik që kanë nisur në kuadrin e mekanizmit rajonal të partneritetit ndërshtetëror të propozuar nga Agjencia Ndërqeveritare e Frankofonisë (AIF) pas Kongresit Frankofon për Formimin Profesional dhe Teknik të Bamakos (maj 1998), vendosën dispozitat e mëposhtme.

Neni 1

Palët kontraktuese vendosën të vazhdojnë së bashku, sipas mundësive të tyre dhe me shpirt solidariteti, përpjekjet e tyre për promovimin, zgjerimin dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e formimit profesional dhe teknik.

Neni 2

Fusha e bashkëpunimit që përbën objektin e kësaj Marrëveshjeje kuadër mbulon veçanërisht realizimin midis krejt ose disa prej palëve kontraktuese:

1. e veprimtarive të partneritetit me karakter kombëtar dhe rajonal me një bashkëpunim të drejtpërdrejtë;

2. e studimeve dhe kërkimeve për zhvillimin e formimit profesional dhe teknik;

3. e veprimtarive në vazhdim, ose që duhen zhvilluar në kuadrin e projektit në ndihmë të politikave kombëtare të formimit profesional dhe teknik të Agjencisë Ndërqeveritare të Frankofonisë, në mënyrë të veçantë e veprimtarive që lidhen me kuadrin global të inxhinierisë së formimit profesional e teknik dhe me bazën e njohurive frankofone;

4. e çdo formë tjetër bashkëpunimi të pranuar nga palët kontraktuese.

Neni 3

Në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, palët kontraktuese përfundojnë marrëveshje bashkëpunimi specifike për realizimin e veprimtarive të partneritetit ndërshtetëror që kanë të bëjnë me fushën e përcaktuar në nenin 2. Këto marrëveshje përcaktojnë termat e referencës, modalitetet dhe mjetet e bashkëpunimit teknik, dhe kushtet e realizimit të veprimtarive, veçanërisht:

- natyrën e veprimtarisë;

- objektivat që duhen arritur;

- kalendarin e punës;

- buxhetin e shpenzimeve dhe planin e financimit;

- detyrimet e secilës palë të interesuar, në mënyrë të veçantë, angazhimet financiare reciproke;

- organizmat përgjegjëse për zbatimin;

- burimet njerëzore pjesëtare dhe të ngarkuara për zbatimin

- modalitetet e ndjekjes dhe të vlerësimit

- Qëllimet dhe rezultatet konkrete afatshkurtëra dhe ndikimi afatgjatë mbi evoluimin e sistemeve të formimit profesional e teknik të vendeve të interesuara.

Neni 4

1. Çdo palë kontraktuese zotohet të formojë një ekip kombëtar me njerëz kompetentë dhe përgjegjës për realizimin e veprimtarive të partneritetit që futen në fushën e përcaktuar nga neni 2, dhe të vër në dispozicion mjetet materiale dhe financiare të nevojshme, veçanërisht mjetet teknike të komunikimit që lejojnë një përdorim efikas të bazës së njohurive frankofone.

2. Ministri ose ministrat e ngarkuar për formimin profesional dhe teknik të çdo pale kontraktuese zotohen të caktojnë dhe madatojnë si përgjegjës (garant) kombëtar të kësaj Marrëveshjeje një nga personat kompetent të sistemit të formimit profesional dhe teknik.

3. Në kuadrin e mandatit të marrë, garanti kombëtar ka për detyrë t'i propozojë ministrat personat që kanë aftësitë për të krijuar ekipin kombëtar, të drejtojnë dhe të gjallërojnë ekipin kombëtar, të kordinojnë për vendin e vet mekanizmin rajonal të partneritetit ndërshtetëror me homologët e vet, t'i sigurojnë ose t'i delegojë çdo anëtar të ekipit të vet kombëtar, koordinimin rajonal të një veprimtarie partneriteti ndërshtetëror. Për këtë qëllim, është krijuar komiteti i lidhjeve të të gjithë përgjegjësve (garantëve) kombëtarë për të koordinuar mekanizmin rajonal të partneritetit ndërshtetëror dhe të gjitha veprimtaritë që rrjedhin prej tij.

4. Sipas modaliteteve dhe mjeteve të bashkëpunimit teknik të përcaktuara në çdo marrëveshje bashkëpunimi, palët kontraktuese mund të kërkojnë financimin e plotë ose të pjesshëm, dhe pjesëmarrjen e të gjitha organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë për realizimin e projekteve që lidhen me fushën e përcaktuar në nenin 2.

Neni 5

Secila nga palët kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e saj përgjegjës, miraton masat e nevojshme për të lehtësuar hyrjen (lëshimin e vizave falas) dhe qëndrimin në vendin e vet të shtetasve të palëve të tjera kontraktuese për realizimin e projekteve të caktuara në marrëveshje kuadër.

Neni 6

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të bëhen objekt rishikimi me kërkesë të një ose shumë palëve kontraktuese. Dispozitat e rishikuara ose të amenduara me pëlqim reciprok hyjnë në fuqi sapo miratohen nga palët kontraktuese.

Neni 7

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Marrëveshje zgjidhet paqësisht me një frymë vllazërimi.

Neni 8

1. Secila nga palët kontraktuese mund ta denoncojnë këtë marrëveshje duke treguar qëllimin e vet me një njoftim me shkrim adresuar secilës palë kontraktuese gjashtë muaj përpara.

2. Denoncimi i kësaj Marrëveshjeje lidhet vetëm me autorin e saj dhe nuk prek zbatimin e projekteve në realizim e sipër ose vlefshmërinë e garancive tashmë të siguruara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Kjo Marrëveshje kuadër mbetet e hapur për çdo vend frankofon të Europës Qendrore dhe Lindore, anëtar ose vëzhgues, nëpërmjet nënshkrimit të një protokollit shtesë.

Kjo Marrëveshje është lidhur për një kohëzgjatje të pacaktuar. Ajo hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të çdo vendi nënshkrues, dhe sipas rastiit, në datën e mbylljes së procedurave ligjore të miratimit specifik për secilën palë kontraktuese.

Bërë në Bukuresht, në 5 nëntor në katër ekzemplarë në gjuhën franceze, tekstet janë të gjithë të njëjtë.

Për Rumaninë:

Për Republikën Bullgare:

Për Republikën e Maqedonisë:

Për Republikën e Moldavisë:

L I G J
Nr. 9558, datë 8.6.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8743, DATË 22.2.2001 “PËR PRONAT E
PALUAJTSHME TË SHTETIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, pika 3 e nenit 8 ndryshohet si më poshtë:

“3. Këshilli i Ministrave miraton listën e inventarit të pronave të paluajtshme të shtetit.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4942, datë 27.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 9559, datë 8.6.2006

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7975, DATË 26.7.1995 “PËR BARNAT NARKOTIKE
DHE LËNDËT PSIKOTROPE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, specialistët e Policisë së Rendit dhe të Policisë Kriminale në zonë, brenda juridiksionit të tyre administrativ, në bashkëpunim edhe me strukturën përkatëse të luftës kundër drogës në drejtorinë e policisë të qarkut, organizojnë punën për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike, zbulimin e sipërfaqeve të kultivuara dhe identifikimin e personave përgjegjës.

2. Kryetari i njësisë bazë të qeverisjes vendore, specialistët e Policisë së Rendit dhe të Policisë Kriminale në zonë, për çdo rast të vërejtjes apo marrjes dijeni për kultivimin e bimëve narkotike në zonën që mbulojnë, janë të detyruar të raportojnë menjëherë me shkrim në strukturën përkatëse të luftës kundër drogës në drejtorinë e policisë të qarkut.

3. Kur personat e mësipërm veprojnë në kundërshtim me pikën 2 të këtij neni, sipas rastit, janë subjekte të veprave penale të parashikuara nga nenet 248, 300 dhe 301 të Kodit Penal.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4952, datë 30.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 9561, datë 12.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8744, DATË 22.2.2001 “PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE TË SHTETIT NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, në nenin 17 bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Transferimi i pronave përfundon sipas procedurave të këtij ligji. Transferime të tjera kryhen sa herë që do të ketë shtesa të funksioneve të njësive të qeverisjes vendore.”.

2. Shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të paragrafit të dytë ndryshohen si më poshtë:

“a) Nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, njësitë e qeverisjes vendore paraqesin në Këshillin e Ministrave listën e pronave, që kërkojnë t’u transferohen, në përputhje me krerët II dhe III të këtij ligji.

b) Këshilli i Ministrave, pasi shqyrton kërkesat e paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas shkronjës “a” të këtij neni, merr vendimin paraprak për listën e pronave, që do t’ia transferojë çdo njësie të qeverisjes vendore. Lista e pronave, që transferohen së bashku me kushtet dhe kufizimet që përcakton Këshilli i Ministrave, sipas këtij ligji, i njoftohet njësisë së qeverisjes vendore, e cila, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit, e shpall atë publikisht.

ç) Këshilli i Ministrave, jo më vonë se 3 muaj nga data e marrjes së kundërshtimeve, vendos përfundimisht për transferimin e pronës, për të cilën ka kundërshtim nga njësia e qeverisjes vendore përkatëse, së bashku me ndonjë kusht ose kufizim që duhet zbatuar për këto prona.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4944, datë 27.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 4953, datë 4.7.2006

PËR FALJE DËNIMI

Në mbështetje të neneve 92 pika b, 93 dhe 94 të Kushtetutës, me propozim të organeve të Pushtetit Lokal,

DEKRETOJ:

Neni 1

1. Artur Haziz Arapaj, dënuar me vendimin nr.360, datë 27.06.2003, nga Gjykata e Rrethit Durrës, i falet dënimi i mbetur.
2. Kostaq Sofokli Llazari, dënuar me vendimin nr.52, datë 23.02.2005, nga Gjykata e Rrethit Korçë, i falet dënimi i mbetur.
3. Pëllumb Mustafa Vizani, dënuar me vendimin nr.227, datë 15.06.2000, nga Gjykata e Rrethit Fier, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
4. Hajredin Hethem Shametaj, denuar me vendimin nr.114, datë 21.10.2003, nga Gjykata e Rrethit Gjirokastrë, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.
5. Kreshnik Tajar Sherifaj, dënuar me vendimin nr. 1, datë 10.03.2004, dënuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda Tiranë, 1 falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
6. Hazbi Daver Kërraj, dënuar me vendimin nr.40, datë 05.05.2005, nga Gjykata e Rrethit Gjirokastrë, i falet dënimi i mbetur.
7. Kostaq Panajot Gjini, dënuar me vendimin nr.58, datë 14.07.2003, nga Gjykata e Rrethit Sarandë, i falet dënimi i mbetur.
8. Etmond Vebi Vezi, dënuar me vendimin nr.10, datë 14.02.2005, nga Gjykata e Rrethit Tiranë, i falet dënimi i mbetur.
9. Shpëtim Ramadan Çepele, dënuar me vendimin nr.71, datë 23.04.2004, nga Gjykata e Rrethit Fier, i falet dënimi i mbetur.
10. Fatjon Besnik Hasimi, dënuar me vendimin nr.124, datë 19.06.2003, nga Gjykata e Rrethit Vlorë, i falet dënimi i mbetur.
11. Taro Lirim Stroka, dënuar me vendimin nr.40, datë 05.05.2005, nga Gjykata e Rrethit Gjirokastrë, i falet dënimi i mbetur.
12. Erjon Lirim Stroka, dënuar me vendimin nr.40, datë 05 .05.2005, nga Gjykata e Rrethit Gjirokastrë, i falet dënimi i mbetur.
13. Barim Islam Flora, dënuar me vendimin nr.266, datë 17.03.2004, nga Gjykata e Rrethit Tiranë, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
14. Lulzim Gjergj Gjini, dënuar me vendimin nr.23, datë 15.07.1999, nga Gjykata e Rrethit Mirditë, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
15. Shkëlqim Rifat Hoxha, denuar me vendimin nr.369, datë 02.07.2003, nga Gjykata e Rrethit Durres, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.
16. Edmond Servet Shaqiri, dënuar me vendimin nr.441, datë 26.04.2004, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, i falet dënimi i mbetur.
17. Agron Meleq Muçaj, denuar me vendimin nr.47, datë 25.03.2004, të Gjykatës së Rrethit Fier, i falet denimi i mbetur.
18. Butjan Hajri Kapa, dënuar me vendimin nr.12, datë 09.02.2005, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, i falet dënimi i mbetur.
19. Arjan Fuat Mydini, dënuar me vendimin nr.34, datë 12 11 2004, të Gjykatës së Rrethit Kolonje, 1 falet dënimi 1 mbetur
20. Caci Ngjeli Vallja, dënuar me vendimin nr.140, datë, 03.11.2004, të Gjykatës së Rrethit Berat, i falet dënimi i mbetur.

21. Astrit Hasan Leza, dënuar me vendimin nr.53, datë 20.05.2004, të Gjykatës së Rrethit Krujë, i falet dënimi i mbetur.
22. Paulin Ejll Kola, dënuar me vendimin nr.16, datë 26.01.2001, të Gjykatës së Rrethit Shkodër, i falet dënimi i mbetur.
23. Mehmet Ali Zharku, dënuar me vendimin nr.01, datë 02.02.2006, të Gjykatës së Rrethit Tropojë, i falet dënimi i mbetur.
24. Fadil Hysen Xhauri, dënuar me vendimin nr.487, datë 08.06.2001, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, i falet dënimi i mbetur.
25. Ermir Mustafa Kroqi, dënuar me vendimin nr.804, datë 19.07.2004, të Gjykatës së Rrethit Tirane, i falet dënimi i mbetur.
26. Vasillaq Kristofor Bollano, dënuar me vendimin nr.20, datë 27.01.2005, të Gjykatës së Rrethit Vlorë, i falet dënimi i mbetur.
27. Klodian Astrit Merko, dënuar me vendimin nr.191, datë 11.09.2003, të Gjykatës së Rrethit Fier, i falet dënimi i mbetur.
28. Liljana Ali Rustemi, dënuar me vendimin nr.290, datë 25.11.2002, të Gjykatës së Rrethit Fier, i falet dënimi i mbetur.
29. Petrit Ymer Bajrami, dënuar me vendimin nr.71, datë 16.03.2005, të Gjykatës së Rrethit Korçë, i falet dënimi i mbetur.
30. Xhensil Vilson Rika, dënuar me vendimin nr.22, datë 15.09.2004, të Gjykatës së Krimeve të Rënda Tirane, i falet dënimi i mbetur.
31. Viktor Avdulla Halilaj, dënuar me vendimin nr.25, datë 24.09.2004, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, i falet dënimi i mbetur.
32. Renato Themis Lena, dënuar me vendimin nr.279, datë 25.03.2003, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, i falet dënimi i mbetur.
33. Artan Besim Xhixha, dënuar me vendimin nr.564, datë 09.06.2003, të Gjykatës së Rrethit Tirane, i falet dënimi i mbetur.
34. Ilir Spirko Karanxha, dënuar me vendimin nr.239, datë 26.09.2005, të Gjykatës së Rrethit Korçë, i falet dënimi i mbetur.
35. Përparim Selim Kiptiu, dënuar me vendimin nr.238, datë 28.10.2003, të Gjykatës së Rrethit Elbasan, i falet dënimi i mbetur.
36. Bledar Pëllumb Aliu, dënuar me vendimin nr.238, datë 28.10.2003, të Gjykatës së Rrethit Elbasan, i falet dënimi i mbetur.
37. Latif Hysen Gjinaj, dënuar me vendimin nr.28, datë 31.03.2000, të Gjykatës së Rrethit Mat, i falet dënimi i mbetur.
38. Dallëndyshe Skënder Muço, dënuar me vendimin nr.228, datë 12.10.2005, të Gjykatës së Rrethit Fier, ndryshuar me vendimin e Gjykatës Apelit Vlorë nr.436, datë 16.12.2005, i falet dënimi i mbetur.
39. Qetsor Nun Kapxhiu, dënuar me vendimin nr.1, datë 26.10.2000, të Gjykatës së Rrethit Skrapar, i falet dënimi i mbetur.
40. Spartak Vlash Nikollaj, dënuar me vendimin nr.531, datë 21.05.2004, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, i falet dënimi i mbetur.
41. Marjan Pashko Kola, dënuar me vendimin nr.80, datë 04.04.2002, të Gjykatës së Rrethit Shkoder, i falet dënimi i mbetur.
42. Sokol Tom Preçaj, dënuar me vendimin nr. 133, datë 18.05.2004, të Gjykatës së Rrethit Shkodër, ndryshuar me vendimin e Gjykatës se Apelit Shkodër nr.276, datë 19.12.2004, i falet dënimi i mbetur.
43. Ermir Shazëman Çaca, dënuar me vendimin nr.128, datë 12.12.2003, të Gjykatës së Rrethit Kavajë, i falet dënimi i mbetur.
44. Çlirim Ismail Gaçaj, dënuar me vendimin nr.77, datë 06.02.2006, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, i falet dënimi i mbetur.
45. Bledar Osman Karameta, dënuar me vendimin nr.83, datë 1.11.2000, të Gjykatës së Rrethit Kavajë, i falet dënimi i mbetur.

46. Sokol Xhelil Skënderi, dënuar me vendimin nr.94, datë 21.12.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër, i falet dënimi i mbetur.
47. Drini Sherid Gjini, dënuar me vendimin nr.13, datë 31.01.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër, i falet dënimi i mbetur.
48. Serjan Pertef Çelo, dënuar me vendimin nr.13, datë 31.01.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër, i falet dënimi i mbetur.
49. Lorenc Asaf Basho, dënuar me vendimin nr.94, datë 21.12.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër, i falet dënimi i mbetur.
50. Gëzim Nikoll Marku, dënuar me vendimin nr.41, datë 10.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Mirditë, i falet dënimi i mbetur.
51. Vladimir Nikoll Gjonmarku, dënuar me vendimin nr.35, datë 02.03.2001, të Gjykatës së Rrethit Durrës, ndryshuar me vendimin nr.254, datë 08.09.2004, të Gjykatës së Apelit Durrës, i falet dënimi i mbetur.
52. Ermal Besnik Koçi, dënuar me vendimin nr.402, datë 11.04.2005, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, i falet dënimi i mbetur.
53. Pelivan Riza Mahmuti, dënuar me vendimin nr.51, datë 13.11.2002, të Gjykatës së Rrethit Sarandë, i falet dënimi i mbetur.
54. Raziq Rustem Mahmutaj, dënuar me vendimin nr.91, datë 28.09.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër, i falet dënimi i mbetur.
55. Alfred Gjini Shyti, dënuar me vendimin nr.4, datë 25.01.2001, të Gjykatës së Rrethit Mirditë, i falet dënimi i mbetur.
56. Elion Neki Koçibelli, dënuar me vendimin nr.196, datë 18.09.2002, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, i falet dënimi i mbetur.
57. Afrim Zenun Byberi, dënuar me vendimin nr.48, datë 13.09.1995, të Gjykatës së Rrethit Tropojë, i falet dënimi i mbetur.
58. Gentian Shaban Neza, dënuar me vendimin nr.173, datë 23.03.2000, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, ndryshuar me vendimin nr.220, datë 23.05.2000, të Gjykatës së Apelit Tiranë, i falet dënimi i mbetur.
59. Lulzim Besnik Rubjeka, dënuar me vendimin nr.36, datë 17.04.2000, të Gjykatës së Rrethit Kavajë, i falet dënimi i mbetur.
60. Shpendi Hajri Basha, dënuar me vendimin nr.97, datë 31.10.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër, i falet dënimi i mbetur.
61. Pirro Gjysh Brokëri, dënuar me vendimin nr.202, datë 04.07.2005 të Gjykatës së Rrethit Korçë, i falet dënimi i mbetur.
62. Rakip Shpendi Dega, dënuar me vendimin nr.29, datë 26.03.2002, të Gjykatës së Rrethit Pukë, i falet dënimi i mbetur.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
 - 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
 - 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
 - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**
-
- 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) 1500**
 - 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 - 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).... 1500**
 - 4. PËR TAKSAT DHE TATIMET (+suplement 2006) 1500**
-
- 1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT..... 1500**
 - 2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT..... 2000**

BOTIME TË REJA

- 1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT 500**
- 2. KODI DOGANOR 1000**
- 3. KODI DETAR 1000**

Hyri në shtyp më 4.7.2006
Doli nga shtypi më 6.7.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë